

VITAMINAT  
NË PEDIATRI

CILI TIP I LËKURËS  
PLAKET MË SHPEJT?



ATMOSFERA  
IDEALE  
E VITIT TË RI E  
SHENJAVE TË  
HOROSKOPIT

# ENERGJI QË TË PUSHTON

Tamara Todevska





# SNUP®

## xylometazoline

**Почетокот на дејството  
е обично во тек на 5-10 минути**

SNUP® спреј за нос, раствор, содржи активна супстанција ксилометазолин која ги стеснува крвните садови на слузницата на носот и со тоа се намалува отокот и се зголемува проодноста на носните канали. Наменет е за олеснување на симптомите кaj затнат нос, хроничен и алергиски ринитис како и кај синузитис.

За назална употреба.



SNUP® спреј за нос, раствор (0.05%) наменет за деца на возраст од 6 до 12 години.  
SNUP 0.05% спреј за нос, раствор не треба да се употребува подолго од 5 дена.

SNUP® спреј за нос, раствор (0.1%) наменет за влезни и деца постари од 6 до 12 години.  
SNUP 0.1% спреј за нос, раствор не треба да се употребува подолго од 7 дена.

**Hemofarm**  
STADA GRUPA



Пред употреба да се прочита упатството!

За индикациите, ризикот од употреба и несакантите дејства на лекот, консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.

## SINDROMA E FSHIKËZËS TEPËR AKTIVE (SPAM)

## VITAMINAT NË PEDIATRI

## BETA-GLUKANI

## CILI TIP I LËKURËS PLAKET MË SHPEJT?

## EKZEMA E PAKËNDSHME

## IMPRESUM

Shef i redaksise: Esin Zekir | Redaktor i fotografise, artistik dhe grafik: Lenca Naumovska  
Bashkëpunetore: Natasa Teovska Mitrovski | Vica Smilovski | Sonja Pecevska | Jasna Jermilova | Martina Dimeska | Vica Stojanovski  
Ilir Demiri | Marija Jankulovska | Taner Hasan | Dragana Petrovski  
Redaktim teknik: Idea Lab DE 000 | Marketing: bettymkd@phoenixpharma.com.mk | Botoni: Evropa 92, rr. Krizhovska, nr. 52, Koçan  
Ilustrimet dhe fotografat: Depositphotos, nese nuk shkruan ndryshe | Ilustrime: Freepik, nese nuk shkruan ndryshe | Tirazh: 24.000

Revista BETTY është një revistë falas mujore, e disponueshme për të gjitha barnatoret që mbështesin BETTY konceptin e marketingut në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Të gjitha përbajtjet dhe reklamat e botuara në revistë janë vetëm nga karakteri informativ dha se asnjë mënyrë nuk mund të zevendësojë vixzë të mjejkut ose farmacisitë. Feniks Farma DODEL Shkup (në tekstin e mëtejme Botues) nuk është përgjegjës për përbajtjen e teksteve të botuara, si dhe përbajtja që reklamohen në revistë, duke përfshirë edhe gabinet osa mosaprimit e pagallimita. Me publikimin e reklameve në revistë, personat juridikë që i reklamojnë produkte të tyre, detyrimi i dispozitave që i dhëzimi per menyrën e reklamimit të ilaqeve dhe palijsave medicinale. Ligji për ilaqet dhe palijsat medicinale, si dhe akte të tjera ligjore, përkatese në territorin e Republikës së Maqedonisë se Vr-tut. Në këtë drejtim, botuesi i revistës përjashton çdo përgjegjësi për dëmt që mund t'ë vijnë nga mosrespektimi i dispozitave të lartpërmendura nga personat juridikë, si dhe për çdo dëmt që vjen nga përdorimi ose abuzimi i përdorimit të përbajtjes që reklamimit të produktave të revistës. Ndalohet përdorimi ose kopimi i përbajtjes së BETTY revistës përfshor qëllime, pa leje, me inkrim të botuesit të revistës.



# SINDROMA E FSHIKËZËS TEPËR AKTIVE (SPAM)


Sindroma e fshikëzës tepër aktive (SPAM) përkufizohet si "një nevojë e papritur dhe e ngutshme për të urinuar me ose pa mosmbajtje urgjente, zakonisht e shoqëruar me urinim të shpeshtë ditën dhe natën, në mungesë të infekzionit të traktit urinar (UTI) ose ndonjë patologji tjeter të dukshme". Kjo është një gjendje që e hasim gjithnjë e më shumë në praktikën tonë të përditshme. Simptomat më të zakonshme të (SPAM) janë urinimi i shpeshtë, që shoqërohet me shpeshtësi të shtuar të urinimit ditën dhe natën dhe përfshin më shumë se tetë urinime në 24 orë ose 2 ose më shumë vizita në tualet gjatë gjumit, urinimi urgent, që paraqet një nxitje të fortë dhe të papritur për të urinuar e cila është vështirë të vonohet dhe mosmbajtja urgjente që paraqet një humbje të papritur të pavullnetshme të urinës. Këto simptoma sugjerojnë aktivitet të tepruar të fshikëzës, por mund të rezultojnë në mbajtje të urinës dhe forma të tjera të mosfunkcionimit të fshikëzës dhe uretrës.

Shkaqet e hiperaktivitetit të fshikëzës nuk janë të përcaktuara mirë, por mendohet se ka disa faktorë që kontribuojnë në këtë gjendje. Anomali të ndryshme neurologjike dhe anatomike urinare të traktit të poshtëm urinar dhe çregullime të tjera mund të shkaktojnë dhe/ose të përkeqësojnë aktivitetin e tepruar të muskujve të fshikëzës.

Sindroma e fshikëzës tepër aktive (SPAM) ndikon ndjeshëm në jetën e miliona njerëzve. Simptomat e lidhura me SPAM-in mund të çojnë në kufizimin e aktiviteteve sociale, si pasojë e shmangjes së shoqërisë dhe shmangjes së udhëtimit për shkak të paarritshmërisë së tualetit, pastaj kufizime psikologjike, duke përfshirë depresionin, fajin, frikën, mungesën e vetëbesimit dhe kufizime profesionale, si mungesa në punë, ulja e produktivitetit dhe dalja në pension të parakohshëm. Ajo gjithashu mund të ndikojë ndjeshëm në aspektet shtëpiake, fizike dhe seksuale të atyre që vuajnë prej saj. Fatkeqësia, shumë prej tyre nuk duan të flasin hapur për gjendjen e tyre me familjarët apo të kërkojnë ndihmë mjekësore.

## FAKTORËT E RREZIKUT

Ka disa faktorë rreziku për sindromën e fshikëzës tepër aktive si: a) mosha më e madhe; b) gratë me lindje të shumëfishata ose të vështira; c) gratë në menopauzë ose me ndryshime hormonale; d) diabeti; e) mbipesha; f) sëmundjet obstruktive të sistemit të frymëmarrjes; g) presioni i lartë i gjakut; h) insuficiencia kronike e veshkave; i) inflamacion i fshikëzës; j) çregullime të sistemit nervor qendror dhe periferik; k) shtatzënia; l) prostata e zmadhuar. Edhe meshkujt që kanë kryer operacion në prostatën mund të kenë rrezik më të lartë të SPAM, si rezultat i kontrollit të dëmtuar nervor të muskujve të fshikëzës apo dyshemesë së legenit ose traumave mekanike të drejtperdrejta në dyshemenë e legenit.



## DIAGNOZA

Sindroma e fshikëzës tepër aktive (SPAM) është një gjendje e zakonshme dhe vlerësimi i pacientit duhet të fillojë me një vlerësim të masës në të cilën kjo gjendje ndikon në jetën e tij të përditshme. Një histori e plotë mjekësore, prania e infeksioneve të shpeshta të traktit urinar, sëmundjet neurogjene dhe kirurgjikale dhe një rishikim i plotë i terapisë me barna, janë thelbësore për të kuptuar përvojën individuale të pacientit me SPAM.

Ekzaminimi fizik mund të sqarojë gjendjet themelore mjekësore që kontribuojnë në shfaqjen dhe zhvillimin e simptomave. Ekzaminimi duhet të përfshijë një ekzaminim të përgjithshëm fizik, me vëmendje të veçantë ndaj ekzaminimit neurologjik dhe ekzaminimit të dyshemesë së legenit. Duhet të vlerësohen edhe segmentet e palcës kurizore nga S2 në S4, ku ndodhet qendra e urinimit motorik. Ekzaminimi i dyshemesë së legenit duhet të vlerësojë shenjat e atrofisë, prolapsin e organeve të legenit, vlerësimin e forcës së muskujve të dyshemesë së legenit dhe çdo anomali anatomike, duke përfshirë divertikulin uretral.

Testimi laboratorik përfshin analizën e sedimentit urinar, kulturën e urinës dhe përfundimisht citologjinë e urinës, nëse gjatë analizës së urinës janë të pranishme simptomat irrituese të fshikëzës dhe ka mikrohematuri të konsiderueshme. Infeksionet e traktit urinar dhe gjendjet kronike irrituese të fshikëzës mund të paraqiten si SPAM. Matja e urinës së mbetur në ultrasonografi mund të ndihmojë në përashtimin e mosmbajtjes me tejmbushje tek meshkujt.



Ekzaminimet uordinamike mund të indikohen për ekzaminim të mëtejshëm të fshikëzës tepër aktive në pacientët me simptoma refraktare, operacione të mëparshme rindërtuese të legenit, duke përfshirë operacionet kundër mosmbajtjes, sëmundjeve neurologjike ose mosfunkcionimit urinar. Metoda të tjera përfshijnë elektromiografinë apo EMG, uretrocistoskopinë dhe cistografinë, ndërsa urografia me CT dhe MR kryhen në raste të jashtëzakonshme.

### MJEKIMI

Trajtimi për SPAM-in dhe mosmbajtjen urinare përfshin ndryshime në stilin e jetës, terapi fizike, barna apo ndërhyrje kirurgjike. Ndryshimet në stilin e jetës dhe masat dietike përfshijnë zvogëlimin e marrjes së alkoolit dhe kafeinës, të cilat irritojnë fshikëzën urinare, pakësimin e përdorimit të barnave të tillë si antihipertensivët, diuretikët, sedativët dhe antidepresivët, humbjen e peshës, zvogëlimin e marrjes së lëngjeve para gjumit, uljen e aktivitetit të rendë fizik dhe stërvitjen e fshikëzës, që përfshin planifikimin e urinimit çdo 2-3 orë. (11)

Terapia fizike nënkupton praktikimin e rregullt të ushtrimeve Kegel, që kontraktojnë muskujt pubokocigjeal dhe paravaginal dhe elektrostimulimin që kryhet në qendra shumë të specializuara duke implantuar të ashtuquajturin "pacemaker".

Terapia me barna përfshin trajtimin me barna antikolinergjike, të cilat janë agjentët farmaceutikë të dëshiruar dhe trajtimi i parë për mosmbajtjen urgjente dhe SPAM-in. Barnat antimuskarinike blokojnë në mënyrë selektive receptorët muskarinikë M2 dhe M3 në fshikëzën e urinës, duke ulur kështu aktivitetin e tepërt të saj dhe duke rritur kapacitetin e fshikëzës, me çka ulet ndjenja e urgjencës. Agonistët beta-adrenergjikë, si mirabegroni, i cili vepron mbi receptorët beta-3 adrenergjikë të muskujve të fshikëzës për relaksimin e saj, janë gjithashtu një mundësi për trajtimin farmakologjik.

Së fundi, natyrisht, trajtimi kirurgjik në zgjidhjen e mosmbajtjes urinare, i cili është një rikthim i pozicionit normal të mbështetjes së segmentit vezikouretral dhe përdoret kryesisht për mosmbajtjen urinare nga stresi.

Qëllimi i të gjitha këtyre metodave është të zvogëlohet nervozizmi i fshikëzës duke relaksuar muskujt ose duke forcuar sfinkterët dhe muskujt e diafragmës urogenitale.

Dr. Ivica Stojanovski, specialist urolog,  
SPQ "8 Shtatori" Shkup



# Левикер®

ПРИРОДНО РЕШЕНИЕ ЗА ПОТКРЕПА НА ЦРНИОТ ДРОБ  
Prunus mume (стандардизиран екстракт) 150 mg и Холин 82.5 mg

ЛЕВИКЕР® придонесува за одржување на нормалната функција на црниот дроб и за нормален метаболизам на мастите. ЛЕВИКЕР® може да ја потпомогне функцијата на црниот дроб додека се употребуваат лекови кои го тераат црниот дроб "да работи прекумерно".

ДОЗИРАЊЕ:

Препорачано дозирање е 1 таблета ЛЕВИКЕР® дневно во времетраење од 3 месеци.



**БИОНИКА**  
ФАРМАЦЕУТИКАЛС  
[www.bionikapharm.com](http://www.bionikapharm.com)

Посветени на хепаталното здравје

# Riniti alergjik gjatë pandemisë COVID-19



Riniti alergjik është një problem shëndetësor global dhe një nga shkaktarët më të shpeshtë për vizitat te mjeku i familjes. Me ardhjen e virusit të ri Sars-Cov 2, infekzionit me korona dhe mbivendosjes së një pjese të simptomatologjisë mes dy subjekteve, situata bëhet edhe më e ndërlidhur. Paraqitura klinike e rinitit alergjik mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme, kurse parimi bashkëkohor i këtij problemi përbëhet nga masat parandaluese dhe aplikimi i terapisë së duhur.

Riniti alergjik klinik shfaqet me simptoma të ngjashme me të ftohtin e zakonshëm, të tilla si hundë e zënë, teshtitje të shpeshta, rrjedhje e një sekrecioni të pastër dhe të tejdukshëm nga hunda, kruajtje e lëkurës së hundës dhe syve, lotim i syve, kollë irrituese dhe gjervishtje në fyt. Simptomat okulare janë më të zakonshme te pacientët me rinit alergjik sezonal. Kur janë të pranishme dy ose më shumë nga simptomat e dhëna dhe të njejtat zgjasin më shumë se një orë në ditë, duhet të dyshojmë për këtë patologji.

Symptomat shfaqen nga fijet e shumta nervore aferente që gjenden në mukozën e hundës, pastaj përmes mekanizmave e reflekseve, përmes qendrave në pons dhe medulla oblongata, ndodhin përgjigje eferente si teshtitja, kongjestioni dhe lotimi i syve. Kontakti i mukozës së hundës me mjedisin e jashtëm ku ka shumë substanca që shkaktojnë alergji, të ashtuquajturit alergjenë, kontribuojnë në përkqësimin e simptomave. Të gjitha këto simptoma çojnë në ulje e cilësisë së jetës së përditshme, pacientët ankohen përfundimisht, dhimbje koke të shpeshta, ankth dhe lodhje kronike, ndikojnë në aftësinë përfundimisht të punuar dhe shoqërohen me mungesa të shpeshta nga puna apo shkolla.

Me ndryshueshmërinë e madhe në paraqitjen e simptomave ndërmjet pacientëve të ndryshëm, te disa ato mund të janë të lehta pa ndikuar në kryerjen e obligimeve të përditshme, deri në të moderuara dhe të rënda, ku ka një ulje të madhe të cilësisë së jetës së përditshme, ulje të gjumit, lodhje kronike, ulje të suksosit në shkollë, ulje të produktivitetit në punë etj.

Është e rendësishme të përmendet ndryshimi i simptomave te i njëjti pacient gjatë viteve. Arsyja pse ndodh kështu nuk është ende mjaft e

qartë, por sipas disa autorëve nuk lidhet me sasinë e alergjenit të pranishëm në ajër. Këta pacientë shpesht kanë sëmundje të tjera shoqëruese të rrugëve të sipërme dhe të poshtme të frymëmarres, si astma alergjike, sinusiti kronik dhe polipoza e hundës.

Zënia e hundës, rrjedhja e hundës, gjervishtjet e fytit dhe dhimbja e kokës mund të janë gjithashtu të pranishme te pacientët me infeksion të COVID-19. Por më shpesht ka simptoma të tilla si ethe, gulçim, të përziera dhe të vjella që nuk janë karakteristike për simptomat e alergjisë.

Dallimi i simptomave të rinitit alergjik dhe COVID-19 bëhet edhe më i ndërlidhur me ardhjen e variantit të ri delta të virusit COVID-19, i cili u izolua për herë të parë në Indi, ku u përhap në mënyrë të prill të vitit 2021. Sipas disa studimeve, simptomat e këtij varianti kanë më shumë mbivendosje me simptomat e rinitit alergjik te popullata e pavaksinuar, por edhe te popullata plotësisht e vaksinuar.

## TRAJTIMI I RINITIT ALERGJIK

Në trajtimin e rinitit alergjik aplikohen masa parandaluese dhe procedura terapeutike. Të gjitha trajtimet terapeutike kanë përfundimisht të kontrollin dhe lehtësimin e simptomave të rinitit alergjik, por jo shërimin e plotë të sëmundjes.

## MASAT PARANDALUESE

Masat parandaluese përfshijnë mënyrën e shmangjes së kontaktit me alergjenët. Gjëja më e rendësishme në këtë drejtim është shmangja e qëndrimit dhe veçanërisht aktivitetit fizik jashtë në periudhën kur ka përqendrim të lartë të një alergjeni të caktuar. Gjithashtu zvogëloni zonën në shtëpi ku mund të grumbullohet pluhuri, veçanërisht në dhomën e gjumit. Kjo mund të arrihet duke hequr qilimat, perdet e rënda, mobiliot e veshura me susta dhe jastëkët me pupla. Veç kësaj, këshillohet përdorimi i mbulesave të bëra nga materiale hipialergjike dhe larja e rrobave në një temperaturë mbi 60 gradë Celsius. Ka edhe studime që kanë treguar një ulje të ndjeshme të përhapjes së alergjive te fëmijët që janë ushqyer vetëm me gjë nga lindja.

Masa të tjera parandaluese përfshijnë pakësimin e kontaktit të

mukozës së hundës me alergjenin nga mjedisi i jashtëm. Këtu përfshihet përdorimi i tretësirave të kripura që përmbajnë ektoinë, e cila mbulon mukozën e hundës si filtrë dhe parandalon kontaktin me alergjenin nga mjedisi i jashtëm. Gjithashtu, pasi të qëndroni në një ambient me sasi të caktuar alergjenësh, ndërroni menjëherë garderobën, bëni dash dhe lani flokët, gjë që do të ulë përqendrimin e alergjenëve në ambientin e ri. Më pas përdorni tretësira të kripura iso dhe hipertonike, duke shtuar substancë të caktuara si aloe vera, kamomil, vaj eukalipti dhe betaglukanë, të cilat kanë efekt të dobishëm në mukozën e hundës, përmirësojnë transportin mukociliar, zvogëlojnëënjtjen në zgavrën e hundës dhe zvogëlojnë sasinë e agjentëve të inflamacionit.

### PROCEDURAT TERAPEUTIKE

Në trajtimin e rinitit alergjik aktualisht janë të regjistrueshë disa preparatë intranasale dhe sistemike, të cilat me përdorimin e duhur mund të zvogëlojnë shumë simptomat e rinitit alergjik, përkatesisht të mbajnë nën kontroll alergjinë. Këto përfshijnë kortikosteroidet intranasale, antihistaminat intranasale, dekongjstantët intranasalë, kortikosteroidet sistematike, antihistaminat, dekongjstantët, preparatet e kromolinit, antagonistët e receptorëve PAF dhe antileukotrienët, ndërsa në studimet e fundit, vend të rëndësishëm në trajtimin e alergjive zënë edhe probiotikët.

Kur në mesin e simptomave të alergjisë mbizotëron kongestionin e hundës, ilaqi i zgjedhur është kortikosteroidi intranasal. Biodisponueshmëria e sprejët është shumë e ulët, zakonisht nën 0.5%, që do të thotë se veprimi është pothuajse tërësisht lokal, pa efekt sistemik. Ka disa forma gjenerike: betamethasone dipropionate, budesonide, fluticasone propionate, mometasone, triamcinolone acetonide. Secili prej këtyre sprejeve ka përparesi dhe mangësi të caktuara, ndaj është shumë e rëndësishme që ato të merren me rekomandim dhe ekzaminim paraprak nga mjeku otorinolaringolog, përfshirë përdorimin e terapinës më efektive. Mënyra e përdorimit të sprejët të hundës është shumë e rëndësishme, gjegjësisht me dorën e majtë spreji aplikohet në vrimën e djathtë të hundës dhe anasjelltas, me dorën e djathtë në vrimën e majtë të hundës. Kësosoj irritohet më pak mukoza e septumit të hundës, e cila është e pasur me enë gjaku, pasi shpesh me përdorimin e gabuar të sprejët intranasal mund të vijë deri te gjakderdhja e padëshiruar nga hunda. Kur efekti i sprejët nazal nuk është i mjaftueshëm, terapisë i shtohen antihistaminat intranasale (azelastina dhe olapatidina) dhe antileukotrienët në tableta (montelukast).

Kur simptomat mbizotërohen nga sekrecionet dhe rrjedhja e hundës, antihistaminat janë zgjedhja e parë, e ndjekur nga shtimi i antileukotrienive dhe kortikosteroideve intranasale. Sipas disa rekomandimeve, antihistaminat orale kanë një efekt më të madh se

antihistaminat dhe leukotrienët intranasal. Ekzistojnë disa grupe antihistaminash (loratadinat, desloratadinat, citerizinat, levociterizinat, feksofenadinat, difenhidraminat). Çdo antihistaminë ka karakteristikat e veta, ndaj duhet marrë gjithmonë me rekomandimin e mjekut, përsëri përfektin më të madh pozitiv në shëndet. Mënyra e marrjes së ilaqit është gjithashtu shumë e rëndësishme, për shembull feksofenadina nuk duhet të merret me ushqim dhe gjatë marrjes së tij nuk duhet të pihet lëng grejpfruti.

Rol në trajtimin e rinitit alergjik luajnë edhe dekongjstantët oralë dhe nazalë. Për dekongjstantët nazalë (oksimetazolinë, ksilometazolinë, pseudoefedrinë) është shumë i rëndësishëm përdorimi i dozave të duhura dhe në kohë relativisht të shkurtër, jo më shumë se 5-7 ditë, në varësi të rekomandimit të prodhuesit për dekongjstantin e dhënë. Çdo përdorim afatgjatë dhe jo i duhur i këtyre barnave ndikon negativisht në mukozën e hundës dhe mund të çojë në rinit medikamentoz, i cili është një entitet i ri për trajtim dhe është një sfidë e madhe në vete për çdo otorinolaringolog. Kur në simptomat e rinitit alergjik kemi një manifestim të alternuar të obstruksionit dhe sekretimit, kombinimi i bromur ipratropiumit intranasal dhe ksilometazolinës ka një efekt të mirë, por me trajtim të kufizuar në 7 ditë.

Sipas hulumtimeve të fundit, disa shtame probiotikësh (Lactobacillus GG, Lactobacillus reuteri, L. gasseri) kanë efekt në parandalimin dhe trajtimin e rinitit alergjik. Lidhja midis probiotikëve nuk është ende plotësisht e qartë për shkencëtarët dhe një numër studimesh janë ende në vazhdim, por ka prova që sugjerojnë një lidhje pozitive.

Përveç trajtimit jospecifik medikamentoz, ekziston edhe një trajtim specifik i quajtur imunoterapi. Imunoterapia nënkupton monosensibilizimin me një lloj alergjeni, siç është një lloj poleni ose një lloj alergjeni gjithëvetor. Nga përvroat e deritanishme, imunoterapia ka efekt më të mirë për polenin e barit dhe pluhurin e shtëpisë. Metoda e imunoterapisë përbëhet nga aplikimi nënlekuror i një sasie të vogël alergjeni përfshirë periudhë të caktuar kohore. Ekziston edhe imunoterapia nëngjuhësore, e cila përfshin sensibilizimin e alergjenit duke marrë një tabletë nën gjuhë. Qëllimi i imunoterapisë është të zvogëlojë dhe në disa pacientë të mënjanjojë plotësisht simptomat e alergjisë.

**Dr. Marija Jankulovska**  
**Otorinolaringologe**





**BETTY**  
farmacist

# HIGJIENA VAGJINALE



Flora e ekuilibruar vaginalë ndihmon në parandalimin e infeksioneve bakteriale dhe kërpudhore dhe është thelbësore për shëndetin e mirë vaginal. Fatkeqësish, numri i grave të diagnostikuara me një lloj infekzioni urogenital është vazhdimisht në rritje. Infeksionet vaginalë më të shpeshta që hasim në punë janë trichomonas vaginalis ose trikomoniazë, kandidazë e aktivizuar, klamidia dhe vaginozat bakteriale me origjinë të ndryshme bakteriale, të cilat vlerësohet të janë të pranishme te më shumë se 50% e popullsisë femërore.

Flora vaginalë është e përbërë kryesisht nga të ashtuquajturat bacile të Doderleinit (të cilat janë shumë të ngashme me mikroorganizmat në formulat probiotike), të cilët kanë një funksion mbrojtës dhe lejojnë vaginalën të mbrohet nga mikroorganizmat patogenë që mund të hyjnë në trup dhe të shkaktojnë infeksion. Në florën vaginalë gjendet gjithashtu kandida dhe në sasi shumë të vogla gardnerela, e cila nëse aktivizohet mund të shkaktojë acarim të mukozës vaginalë dhe simptoma shumë të pakëndshme.

Flora vaginalë duhet të mirëmbahet me higjenë normale, jo shumë shpesh, të mos lahet me sapun, megjithëse ka xhelra për kujdes intim që mund të aplikohen herë pas here, por duhet të janë me një pH që nuk do ta prishë pH-në natyrore të vaginalës. Duhet të përdoren produkte që kanë pH të ngashme me atë të florës vaginalë, pra nuk duhet të përdoren xhelra me pH mbi 4.5. Preparatet me pH mbi atë vlerë mund të prishin florën vaginalë.

Simptomat më të zakonshme për të cilat çdo grua duhet të jetë e vetëdijshme janë kruajtja, djegia, inflamacioni, ndryshimi i ngjyrës dhe erës, si dhe dendësia e sekrecionit dhe çdo acarim tjetër që mund të ketë lidhje me traktin urogenital. Kur shfaqen këto simptoma, veçanërisht nëse zgjasin më shumë se një ose dy ditë dhe vazhdojnë e përparojnë, është e nevojshme të vizitoni gjinekologun dhe të bëni një ekzaminim.

Për të ruajtur higjenën dhe mikroflorën e shëndetshme, mund të përdorni edhe preparate që gjenden më shpesh në barnatore, si xhelrat për kujdes intim, të cilët në një florë të shëndetshme, mjafton të përdoren një herë në javë. Megjithatë, nëse flora vaginalë është pak e prishur, gjë që mund të sjellë edhe simptoma të caktuara shpimi gjilpërash, kruajtjeje ose shqetësimi, mund të përdoren preparate me prebiotikë, që nuk kanë efekte negative dhe që mund ta kthejnë florën vaginalë në normalitet, duke zhdukur simptomat në fjalë. Por sigurisht që, në rast të këtyre simptomave, është mirë të bëhet një ekzaminim gjinekologjik. Vagjina është e ndërtuar ashtu që të mbahet e pastër me ndihmën e sekrecioneve natyrale (shkarkimit). Zbuloni se si të ndihmoni në mbajtjen e vaginalës suaj të pastër dhe të shëndetshme.

## 12 RREGULLAT THEMELORE PËR HIGJENËN INTIME TE GRATË:

Ruajtja e higjenës në zonën intime është jashtëzakonisht e rëndësishme për gratë, jo vetëm për t'u ndjerë më të pastra dhe më të freskëta, por edhe për të shëmangur problemet e pakëndshme dhe ndonjëherë të rrezikshme shëndetësore që mund të shfaqen. Ja rregullat bazë për ruajtjen e higjenës së mirë atje poshtë:

1. Sapunët e zakonshëm dhe xhelrat e dushit nuk janë të përshtatshëm për larjen e vaginalës. Shumica e sapunëve dhe xhelrave janë krijuar për të ruajtur pH-në natyrore të lëkurës prej 5.5. Por pH-ja normale e një vagjine të shëndetshme sillet nga 3.8 në 4.5. Përdorimi i sapunëve të zakonshëm mund të prishë florën natyrore vaginalë, duke lejuar kështu rritjen dhe shumëzimin e papenguar të baktereve të dëmshme. Si pasojë, mund të vijë deri te acarimi, kruajtja, dhimbja, era e pakëndshme, rrjedhja jonormale apo infeksioni. Prandaj, kini kujdes kur blini produkte të higjenës intime. Shumë gjinekologë këshillojnë të përdorni vetëm ujë të ngrohtë, por nëse vendosni se nuk mjafton, përdorni vetëm produkte të parapara për kujdesin e zonës intime.

2. Lani vetëm pjesën e jashtme të vaginalës. Vagjina ka aftësinë të pastrohet vetë, ndaj nuk është e nevojshme të shpëlaltet nga brenda, madje mund të thuhet se është e dëmshme. Kjo do të thotë se duhet të lani vulvën, buzët dhe zonën rrëth klitorisit.

3. Lahu poshtë një herë në ditë. Lani zonat intime me ujë të ngrohtë të paktën një herë në ditë. Rekomandohet larja pas çdo zbrasjeje të zorrëve për të parandaluar transmetimin e baktereve në vaginalë. Kur jeni me menstruacione, lajeni dy herë në ditë vetëm me ujë të ngrohtë.

4. Mos përdorni sfungjerë apo doreza. Sfungjerët dhe dorezat mund të shkaktojnë lëndime të vogla në lëkurën e butë dhe delikate të vaginalës. Mjafton të përdorni dorën gjatë larjes.

5. Mos e drejtoni rrjedhën e ujit drejt përdrejt kah vagjina. Lëreni ujin të rrjedhë nga lart poshtë për të parandaluar që bakteret të hyjnë në brendësi.

6. Përdorni gjithmonë një leckë të butë dhe të thatë. Pëlhura me të cilën do të fshiheni pas larjes duhet të jetë e butë dhe plotësisht e thatë. Ndërrojeni çdo 2-3 ditë dhe përdoren vetëm ju.

7. Fshihuni nga përpara prapa. Pasi të keni kryer nevojën, fshijeni veten me letër higjenike nga përpara prapa, dmth. nga vagjina drejt anusit.

8. Vishni të brendshme pambuku. Veshjet e pambukut e lejojnë lëkurën të marrë frymë. Ndryshe nga pambuku, materialet sintetike parandalojnë qarkullimin e ajrit, rrisin lagështinë në zonën intime dhe kështu krijojnë një mjesid ideal për zhvillimin e baktereve. Vishni të brendshme pambuku çdo ditë, kurse brekët me dantella ruajini vetëm për mbërëmje të veçanta. Gjithashtu, shmangni veshjen e xhinseve dhe pantallonave të ngushta.

9. Lani pjesët intime para dhe pas marrëdhënies seksuale. Përveç kësaj,

është shumë e rëndësishme që partneri juaj të mbajë higjienë të mirë intime.

10. Seksi gjatë menstruacioneve mbart një rrezik të shtuar të infekSIONEVE. Prandaj,shmangeni atë. Nëse jeni të prirur ndaj infekSIONEVE, abstenoni derisa gjakderdhja menstruale të përfundoj.

11. Gjatë menstruacioneve ndërroni pecetat higjienike çdo 2-4 orë. Mos e lejoni veten të qëndroni me të njëjtën pecetë për më shumë se 4 orë. Në të kundërtën, jo vetëm që nuk do të ndiheni të freskëta, por do t'i jepni hapësirë edhe shumëfishimit të baktereve të dëmshme.

12. Përdorni tamponë më rrallë dhe ndërrojini çdo 2-3 orë. Asnjëherë nuk duhet të flini me tampon. Tamponët duhet të ndërrohen rregullisht pasi mund të shkaktojnë infeksione ose sindromë të shokut toksik, e cila konsiderohet si një sëmundje potencialisht fatale. Mos përdorni tamponë nëse keni një infekzion.

Për problemet vagjinale rekomandohet përdorimi i kombinuar i banjës dhe kremit, ndonëse natyrisht, higjena e mirë bazë, gjumi i bollshëm dhe një dietë e plotë me marrjen e një sasie të duhur të lëngjeve janë gjithmonë një ide e mirë për shëndetin vaginal, si dhe për shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme.

#### Përbërësit e banjës intime 200 ml:

Xhel i butë dhe i tejdukshëm për kujdesin intim përmban acid laktik, pantenol, glicerinë dhe alantoinë.

#### Indikacionet për aplikimin e banjës intime:

Ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit të pH-së vaginale, qetëson, hidraton dhe largon ndjenjën e pakëndshme të kruajtjes dhe shpimit. E përshtatshme për përdorim gjatë menstruacioneve, shtatzënise dhe pas lindjes. Këshillohet gjithashtu në rast të rritjes së rezikut të infeksioneve bakteriale dhe kërpudhere (ushtime fizike, not në pishina, udhëtime të gjata pune).

#### Rekomandime për aplikimin e banjës intime:

Aplikoni një sasi të mjaftueshme të banjës në lëkurë të lagur dhe shpëlajeni mirë. Përsëriteri aplikimin sipas nevojës në rast se acarimi nuk ndalet ose nëse është e nevojshme.

#### Përbërësit e kremit intim 30 ml:

Formulimi me efekt antimikrobiq: bisabolol (përbërës natyral i kamomilës (lat. Matricaria chamomilla), acid hialuronik, acid laktik, vitaminë E (në formë provitaminë).

#### Indikacionet për aplikimin e kremit intim:

Këshillohet në rastet e ndjesisë së pakëndshme të kruajtjes, ndjesisë së shpimit të gjilpërave, acarimit, skujjes, aromave të padëshiruara dhe në rastet e rritjes së rezikut të infeksioneve të shkaktuara nga bakteret dhe kërpudhat. Është i përshtatshëm për përdorim gjatë shtatzënise dhe pas lindjes.

#### Rekomandim për aplikimin e kremit intim:

Aplikoni një sasi të mjaftueshme të kremit në lëkurën e jashtme të organizmit intim. Përsëriteri aplikimin derisa të zhduket ose sipas nevojës.

Produkti është i përshtatshëm për përdorim:

- Në higjienën e përditishme
- Te të gjitha llojet e lëkurës
- Te fémijët mbi 3 vjeç
- Te gratë shtatzëna
- Në periudhën pas lindjes

Martina Dimeska  
Magjistre e farmacisë  
IPSH Barnatore Menta, Prilep



SYNERGY

ПРИРОДНИ ВИТАМИНИ

www.synevit.net  
02 3225 843

ELLE

# ENERGJI QË TË PUSHTON

Tamara Todevska

VITI I KALUAR ISHTE NJË VIT I MREKULLUESHËM PËR TY NGA ANA PROFESIONALE. PËR ÇFARË DO TA MBASH MEND MË SHUMË?

Nga ana profesionale, për koncertet në amfiteatrin në Ohër dhe Herakle. Ajo ishte një arritje e madhe, ndonëse shumë e pasigurt në shumë aspekte, sepse ndodhi për herë të parë që kur po përballemi me një pandemi globale. Kam pasur raste të tjera për të qenë e lumtur dhe jam sinqerisht e kënaqur me atë se sa kam arritur të përmbytë në këtë situatë. Edhe këtë vit iu përkushtova punës në studio, ku regjistrova këngën "Porok", e cila është një ndër të shumtët që i kam regjistruar, por e vetmja që e kam publikuar, duke qenë se jam duke përgatitur një album të plotë pa afat publikimi. Ka edhe një ngjarje që më gjëzoi shumë, e cila është koncerti në Kala me rastin e 30 vjetorit të pavarësisë së Maqedonisë, ku këndova këngë të pavdekshme maqedonase dhe bashkëpunova me orkestrën e filarmonisë, Shoqatën e Muzikantëve Jazz dhe mjeshterin Emin Xhijan.

TEMPERAMENTI YT I PASHTUAR PASQYROHET VAZHDIMISHT NË KËNGËT E TUA, SI DHE NË PAMJEN TËNDE FIZIKE. SIDOMOS NË VITIN QË LAMË PAS, KA PASUR PERIUDHA KUR U PARAQITE ME NJË STIL MË NDRYSHË, POR EDHE NË FORMË TË MIRË. SI DO TA PËRSHKRUAJE TË GJITHË PROCESIN E TRANSFORMIMIT?

Nuk besoj se pas kësaj do të doja një tjetër transformim. Deri tani kam pasur shumë përpjekje për ta mbajtur formën në gjendje të mirë dhe nuk ka shkuar mbarë, sepse gjithçka ishte e lidhur me afate dhe kohën e lirë. Këtë herë përpjekem që jetesën e shëndetshme dhe sportin ta bëj shprehi të përditshme, me qëllim që të kem energjinë për të cilën kam aq shumë nevojë, si përritjen e fëmijëve, ashtu edhe për angazhimet e mia profesionale. Por më duhet të them se nuk më pëlqen shtypja që na vihet ne femrave nga mediat për sa i përket pamjes sonë. Skena botërore ka një qasje pak më ndryshe dhe këto shtypje synojnë të nxisin muzikantët dhe këngëtarët që të jenë rehat me pamjen e tyre, edhe kur janë mbipeshë. Ajo që duhet të jetë fokus i publikut dhe i medias është kënga dhe nëse ajo që këndojmë të prek shpirtin.



The advertisement features a woman in a red raincoat holding a purple umbrella, looking up and smiling. The umbrella is decorated with four yellow circles containing Cyrillic text: 'Витамин Ц' (Vitamin C) at the top right, 'Цинк' (Zinc) on the right side, 'Селен' (Selenium) at the bottom right, and 'Витамин Д12' (Vitamin D12) on the left side. In the bottom right corner, there is a product box for 'MULTI ESSENCE ИМУНО' (Immuno) vitamins, which are microgranules for direct application. The box also lists 'Витамин Ц, Цинк, Селен, Витамин Д, Витамин Б2'. In the bottom left corner, there is a circular logo for 'АЛКАЛОИД СКОПЈЕ' (ALKALOID SKOPJE) with the text '85 години' (85 years) and 'Здравјето првично' (Health first). The word 'ИМУНО' (Immuno) is prominently displayed in large white letters across the bottom of the advertisement.

MULTI  
ESSENCE

ИМУНО

Микрограмули за директна примена

Витамин Ц, Цинк, Селен, Витамин Д, Витамин Б<sub>2</sub>

40 g

ALKALOID  
СКОПЈЕ

85 години

Здравјето првично

## ÇFARË DO TË THOTË PËR TY "JETESË E SHËNDETSHME"?

Për mua, jetesë e shëndetshme, përveç shprehive të shëndetshme, është edhe një ditë e mirëorganuar. Një ditë në të cilën do të kem kohë për familjen dhe për çlodhje. Jetesa më e pashëndetshme që e kam bërë ndonjëherë ishte kur nuk ndalesha duke punuar. Por isha edhe shumë më e re, kështu që doja të argëtohesha. Tani argëtimi im më i madh është të dal në natyrë me familjen.

## SI NËNË E DY FËMIJËVE, ÇFARË SHPREHISH TË SHËNDETSHME DËSHIRONI TU KALOSH HANËS DHE DARENIT?

Të njëjtat gjëra që çdo nënë dhe baba do t'ua kalonte fëmijëve të vet. Por ajo që dua t'u mësoj është që të kenë empati dhe të dinë se fakti që ata kanë privilegjin të kenë gjithçka që duan, nuk bie nga qielli, por se fitohet me mund dhe meritë. Dua që të kenë vlerat të cilat unë i çmoj tek njerëzit.

## ÇFARË BËN NË KOHËN E LIRË? ÇFARË TË FRYMËZON DHE TË RELAKSON?

Unë fle kur jam vërtet e lirë dhe ajo ndodh vetëm kur bashkëshorti im shkon me fëmijët në Gjevgjeli për fundjavë te gjyshërit. Atëherë kam dy miq që më shoqerojnë: Netflix dhe dhoma e gjumit. Asisoj kohe të lirë kam rrallë.



## A JE QEJFLIE E TË NGRËNIT DHE NËSE TË DUHET TË VEÇOSH NDONJË KUZHINË BOTËRORE, CILA DO TË ISHTE AJO?

Kam ndryshuar. Nuk jam qejflie e të ngrënët dhe nuk i admiroj specialitetet si dikur. Tani ushqimi për mua është një mjet energjie dhe një paketë lëndesh ushqyese të nevojshme për ta kaluar ditën dhe për t'i plotësuar të gjitha nevojat ushqyese. Kjo ka ndodhur që kur e ndryshova mënyrën e të ushqyerit dhe përparrësitë në jetë. Më pëlqen që çdo dy javë të gostitemi të gjithë me një vakt të veçantë në shtëpi ose në restoran dhe pastaj përsëri jam unë ajo që ha vetëm sallatën.



MEQENËSE USHTRON RREGULLISHT, ÇFARË DO TË DOJE T'U THUASH TË GJITË  
ATYRE QË U MUNGON MOTIVIMI?

Sado herë që të hiqni dorë nga sporti, nuk është kurrë vonë për të filluar përsëri.

CILAT JANË PLANET E TUA MUZIKORE PËR VITIN 2022?

Profesionalisht, ndryshe nga më parë, nuk kam plane, por kam dëshira për të pëmirësuar procesin e krijimit të muzikës. Mendoj të bashkëpunoj me muzikantë me të cilët do të punoj së bashku në krijimin e muzikës sime. Më vjen mirë që pas një sërë suksesesh mund t'i jap vetes lirinë e krijimtarisë dhe të shoh se çfarë do të sjellë një qasje e tillë.

PËR FUND, CILAT JANË DËSHIRAT E HANËS DHE DARENIT NGA BABA DIMRI?

Hana nuk është shumë e emocionuar për Baba Dimrin, sepse mendon se ai nuk mund t'i japë diçka më tepër se ajo që do të kërkojë prej nesh. Duket sikur e kemi llastuar. Për Darenin do të jetë interesante, sepse është në një moshë kur fëmijët i gëzohen për herë të parë mysafirit nga Laponia dhe dhuratave që do t'i sjellë ai.





MULTI  
ESSENCE

ПОВЕЌЕ  
ОД ВИТАМИН...



ХРАНА ЗА ПОСЕБНА НУТРИТИВНА УПОТРЕБА - ХРАНА ЗА ПОСЕБНИ МЕДИЦИНСКИ НАМЕНИ

MULTI ESSENCE

ВИТАМИН Д<sub>3</sub> 1000 І.У.

30 лекув. капсули

АЛКАЛОИД СКОПЈЕ



ХРАНА ЗА ПОСЕБНА НУТРИТИВНА УПОТРЕБА - ХРАНА ЗА ПОСЕБНИ МЕДИЦИНСКИ НАМЕНИ

MULTI ESSENCE

ВИТАМИН Д<sub>3</sub> 4000 І.У.

30 лекув. капсули

АЛКАЛОИД СКОПЈЕ



ВИТАМИН  
Д<sub>3</sub>



ХРАНА ЗА ПОСЕБНА НУТРИТИВНА УПОТРЕБА - ХРАНА ЗА ПОСЕБНИ МЕДИЦИНСКИ НАМЕНИ

MULTI ESSENCE

ВИТАМИН Д<sub>3</sub> 2000 І.У.

30 лекув. капсули

АЛКАЛОИД СКОПЈЕ

ХРАНА ЗА ПОСЕБНА НУТРИТИВНА УПОТРЕБА -  
ХРАНА ЗА ПОСЕБНИ  
МЕДИЦИНСКИ НАМЕНИ



85  
ГОДИНИ  
АЛКАЛОИД  
СКОПЈЕ  
За животот будујќи



# Vitaminat në pediatri

Vitaminat janë komponime organike të përbëra që kanë një rëndësi të madhe për funksionimin normal të organizmit të njeriut. Sipas tretshmërisë, ndahen në të tretshme në ujë apo hidrosolubile dhe të tretshme në yndyrë apo liposolubile.

Në grupin e vitaminave të tretshme në ujë bëjnë pjesë vitamina C dhe vitaminat e kompleksit B, ndërsa të tretshme në yndyrë janë vitaminat A, D, E dhe K. Burimi kryesor i vitaminave janë produktet ushqimore, me përjashtim të vitaminës D e cila prodhohet në lëkurë nën ndikimin e rrezeve UV, dhe vitaminave K, B2 dhe biotinës, që prodhohen nga bakteret në zorrë të trashë.

Vitaminat nuk kanë veti të depozitohen në organizmin e njeriut, përvëç vitaminës B12 e cila depozitohet në mëlci, prej nga rrjedh edhe nevoja për marrjen e tyre të përditshme me ushqim. Duke marrë parasysh specifikat e trupit të fëmijës, i cili eshtë vazhdimit në fazën e rritjes dhe zhvillimit, arrijmë në përfundimin se mungesa e vitaminave, por edhe teprica e tyre, mund të ndikojnë ndjeshëm në shëndetin e fëmijës. Megjithatë, nëse ushqimi eshtë i rregullt dhe i duhur, rrallëherë vjen deri te dëmtimi i shëndetit të fëmijës. Çrregullimet janë përgjithësisht të rralla dhe ndodhin vetëm në kontekstin e sëmundjeve të ndryshme që komprometojnë marrjen dhe shpërndarjen e tyre në organizëm.

Karakteristike për popullatën e fëmijëve eshtë dieta e ndryshme për një moshë të caktuar. Në vitin e parë të jetës, më saktë në 5 deri në 6 muajt e parë, dieta e foshnjës eshtë kryesisht qumështore. Fëmijët që ushqehen me gjë marrin doza optimale të të gjitha vitaminave, përvëç vitaminës D, ndërsa fëmijët që konsumojnë qumësht formulë zakonisht nuk kanë nevojë për plotësim shtesë të vitaminave, duke qenë se ajo siguron marrjen optimale.

Pas muajit të gjashtë, kur fillohet me një dietë joqumështore, fëmija i plotëson nevojat për vitamina nga dieta. Nëse fëmija ushqehet me qumësht lope që nuk ka sasi të mjaftueshme të vitaminës A dhe C, plotësimi eshtë i domosdoshëm. Theksoj se nevojat për vitamina te fëmijët e lindur para kohe dhe tek ata me peshë më të ulët të lindjes janë më të mëdha, ndaj edhe këtu plotësimi eshtë i domosdoshëm.

Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet vitaminës D, e cila eshtë një faktor i rëndësishëm në metabolizmin e kalciumit dhe fosforit, në funksionin e qelizave bazë, në imunitet dhe funksionin hormonal. Mungesa e vitaminës D kontribuojnë sëmundje të rënda të sistemit skeletor, rakin dhe osteopeni te fëmijët dhe osteomalaci te të rriturit Përvëç sëmundjeve të sistemit skeletor, mungesa e vitaminës D eshtë shpesh shkaku i disa sëmundjeve autoimune, alergjive dhe sëmundjeve të zemrës.

Nga pikëpamja biologjike, burimi kryesor i vitaminës D janë rezet e diellit. Nën veprimin e tyre vjen deri te krijimi i kesaj vitamine në lëkurë, e njohur si vitamina D3. Mirëpo, frika e arsyeshme nga rrezitja si shkak për paraqitjen e sëmundjeve malinje në lëkurë ka ulur burimin bazë të vitaminës D, duke imponuar kështu nevojën për plotësimin e saj shtesë. Sipas pikëpamjeve bashkëkohore, marrja e rekomanduar e vitaminës D eshtë në kontekstin e moshës, kështu që për moshat 0 deri në 18 vjeç nevojiten 400 IU në ditë, kurse për ata mbi 18 vjeç nga 600 deri në 800 IU. Nevoja për plotësimin e vitaminës D eshtë e domosdoshme në vitin e parë të jetës dhe eshtë 400 IU në ditë, pa marrë parasysh me çfarë qumështi ushqehet fëmija. Pas vitit të parë dhe duke pasur parasysh klimën dhe shprehitë tonë, plotësimi rekomandohet vetëm në muajt e ftohtë, në mënyrë periodike deri në vitin e tretë.

**Dr. Jasna Jermilova**  
**Mjeke pediatre IPSH Medika MIM**



# Вашата *Нова* Дневна Рутина

Taffix спреј за нос, прашок



## Што е Taffix®?

спреј за нос, прашок кој се користи за блокирање на вируси во носната празнина, вируси кои можат да навлезат во респираторниот систем и да предизвикаат инфекција.

Го Намалува  
**Ризикот**  
од вирусни  
инфекцији

Делува **1**  
за само  
**Минута**

**5** Штити  
часа  
со секоја  
употреба

## Кога да се употребува Taffix®?

пред изложеност на средина со висок ризик, каде што можат да се пренесат вируси, како што се јавни места (супермаркети, аптеки, училишта, спортски клубови, авиони, итн.).

## Како делува Taffix®?

во носот, прашокот се претвора во гел и создава активна бариера која заштитува од вируси и деактивира вируси кои се пренесуваат во воздухот.



Пред употреба внимателно да се прочита упатството!  
За индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејства на медицинското средство консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.



# SI TË PARANDALONI DHE MENAXHONI OBEZITETIN?

Obeziteti përkufizohet si një sëmundje kronike, përparuese dhe e përsëritur, me origjinë multifaktoriale. Kjo sëmundje shoqërohet me një rritje të yndyrnave në trup dhe ndërprerje të funksionit të indit dhjamor, që çon në dëmtim të funksioneve metabolike, biokimike dhe psikosociologjike. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), obeziteti pranohet si sëmundje.

Kohët e fundit obeziteti ka marrë përmasa epidemike në mbarë botën, kurse për përcaktimin e tij përdoret indeksi i masës trupore (IMT), i cili përkufizohet si koeficient i peshës trupore dhe lartësisë në metra katrorë ( $\text{kg}/\text{m}^2$ ). Sipas këtij indeksi, personat klasifikohen në grupet në vijim: persona me IMT normale: 18.5 - 24.9; masë e tepërt trupore IMT: 25.0 - 29.9; klasa e parë e trashësisë me IMT: 30.0 - 34.9; klasa e dytë e trashësisë me IMT: 35.0 - 39.9 dhe klasa e tretë e trashësisë me IMT: e barabartë ose mbi 40  $\text{kg}/\text{m}^2$ .

Shkaku kryesor i obezitetit është një çekuilibër midis kalorive të konsumuara dhe kalorive të shpenzuara. Ky çekuilibër shkaktohet nga konsumimi i ushqimeve me shumë kalori dhe të pasura me yndyma dhe sheqerna të thjeshta, mungesa e aktivitetit fizik, stili i jetesës ulur dhe urbanizimi. Nëse tregohet kujdes për të pakësuar ose mënjanuar këto shkaqe, atëherë obeziteti mund të parandalohet.

Obeziteti është i lidhur me më shumë se 200 probleme shëndetësore, duke përfshire sëmundjet kardiovaskulare, diabetin, sëmundjet pulmonare obstruktive kronike, kancerin, si dhe sëmundjet gjinekologjike, muskulo-skeletore dhe psikiatrike. Si rezultat i këtyre ndërlilikimeve shëndetësore, shkalla e përgjithshme e vdekshmërisë tek njerëzit po rritet. Gjithashtu, këto ndërlilikime shëndetësore shkaktojnë shpenzime të mëdha të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, që vijnë në shprehje përmes uljes së cilësisë së jetës, aftësisë për punë dhe produktivitetit.

Obeziteti duhet trajtuar dhe synimi duhet të jetë ulja e peshës së përgjithshme trupore me 5 deri në 15%. Për ta arritur këtë qëllim, mënyra më adekuate e të ushqyerit është dieta mesdhetare. Kjo dietë mund të përshtatet me një porcion ushqimi në një pjatë. Pjata ndahet në tre pjesë, gjysma e të cilave duhet të përmbajë perime, një e katërtë duhet të përmbajë proteina me prejardhje shtazore ose bimore dhe çereku i fundit duhet të përmbajë sheqerna komplekse, duke përfshire drithërat. Ky duhet të jetë një shembull i ushqyerjes së duhur.

Në rast se ndryshimi i stilit të jetesës dhe dietës nuk i plotëson qëllimet e përcaktuara më parë, pason terapi me barna ose kirurgji bariatrike. Terapia me barna mund të jepet si injeksion nënlikuror një herë në ditë ose një herë në javë ose përmes tabletave orale. Krahas efekteve të drejtpërdrejta në uljen e oreksit dhe peshës, barnat kanë edhe efekte pozitive të tërthorta në zemër, enët e gjakut dhe metabolizëm, si dhe efekte psikosociologjike. Për më tepër, terapia me barna mundëson ruajtjen e humbjes së peshës, e cila është e një rëndësie të veçantë, duke pasur parasysh se një nga problemet kryesore pas humbjes së peshës është prirja e trupit për të rifituar peshën e humbur. Terapia me barna është tashmë në përdorim në vendin tonë.

Njerëzit obezë duhet të konsultohen me mjekun e tyre për mundësitë e terapisë së obezitetit. Nëse terapia konvencionale është e pasuksesshme, si zgjidhje e fundit mund të përdoret kirurgjia bariatrike. Kirurgjia bariatrike përfshin ndërhyrjen në lukth për të ulur konsumimin e ushqimit. Kjo metodë terapeutike përdoret më shpesh te personat obezë morbid, IMT-ja e të cilëve është mbi 40  $\text{kg}/\text{m}^2$ , ose IMT-ja e të cilëve është e barabartë ose mbi 35  $\text{kg}/\text{m}^2$  dhe kanë një ose më shumë probleme shëndetësore shoqëruese.

Mund të thuhet se obeziteti, me gjithë ndërlimet serioze të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, është ende një sëmundje e parandalueshme që mund të trajtohet. Trajtimi i obezitetit nuk duhet anashkaluar, sepse obeziteti është në radhë të parë një problem serioz shëndetësor dhe vetëm në radhë të dytë një problem i mundshëm estetik.

Dr. Taner Hasan, endokrinolog subspecialist  
Reparti i endokrinologjisë, IPSH Spitali i Përgjithshëm "8 Shtator", Shkup

# Кога ќе ослабнам, луѓето ми велат дека изгледам одлично. Кога ќе ги вратам килограмите, тие ме прашуваат што тргнало наопаку...

Многу луѓе претпоставуваат дека постигнувањето здрава телесна тежина е крај на патешествието поврзано со slabeeњето.

Но, факт е дека не по наша вина, може да биде тешко да ги задржиме килограмите откако ќе ги изгубиме.

Една од причините е тоа што по намалување на телесната тежината, нашето тело ги зголемува сигналите кои го стимулираат апетитот, што честопати нè тера да јадеме повеќе и да ја вратиме телесната тежина.

Па, важно е да се разбере дека постигнувањето на нашата идеална здрава телесна тежина не е праволиниско со тек на времето. Подеми и падови се сосема нормални.

За повеќе да ја разберете дебелината или ако сметате дека се соочувате со дебелина, започнете со разговор - зборувајте со вашиот лекар, медицинска сестра или фармацевт за поддршка и совет којшто е соодветен за вас.

*Вашиот пат до поздрава телесна тежина  
може да започне со разговор!*



Овој едукативен материјал е подготвен од страна на Ново Нордиск и е наменет за општа популација со цел да се зголеми свесноста за дебелината.

За повеќе информации посетете ја  
[www.truthaboutweight.co.uk](http://www.truthaboutweight.co.uk)

Ново Нордиск Фарма ДООЕЛ  
ул. Никола Кљусев бр. 11, Скопје, Р. С. Македонија  
тел: +389 2 2400 202; [www.novonordisk.mk](http://www.novonordisk.mk)  
D-19/01-11/2021

Ова не е вистински пациент, тука илустрација.





# për muajin DHJETOR

# VEÇOJMË



**LIVSANE**  
Pije e ngrohtë me  
manaferra të egra  
10 qese



**LIVSANE**  
Pije e nxeh të me xhenxhefil,  
mjaltë dhe limon  
10 qese



**LIVSANE**  
Vitaminë C  
Pluhur  
100 gr.



Sapun me qumësht dhie



Topa shkumëzues për këmbë



Sapun me glicerinë



**SeptaNazal®**  
për të rritur  
sprej për  
hundë  
10ml



**СептаНазал®**  
за деца  
спреј за нос  
10ml



**ProBeta Glukan®**  
30 qese pluhur



**Imunitinn® MR + Imunitinn® C+Zn *FALAS***



**FALAS**



**ПОСЈАЈНА КОЖА  
ЗА САМО 1 НЕДЕЛА**

**Neutrogena Bright Boost**  
**Krem xhel**  
50ml

**Neutrogena Bright Boost**  
**Piling**  
75ml

**Neutrogena Bright Boost**  
**Krem nate**  
50ml



**DOCTOR'S Bronko salep**  
4 qese

**DOCTOR'S**  
**Salep për duhanpirësit**  
4 qese

**DOCTOR'S**  
**Salep për fëmijë**  
4 qese



Para përdorimit, Ju lutemi lexoni udhëzimet e paketimit me kujdes.  
Për më shumë informacion kontaktoni mjekun ose farmacistin tuaj.

# BETA-GLUKANI

## *imunostimuluesi më i fuqishëm natyror*

Substancat që me mekanizmin e tyre të veprimit forcojnë imunitetin dhe në këtë mënyrë rrisin rezistencën e organizmit dhe efektivitetin e tij në mbrojtjen nga ndikimet e dëmshme, quhen imunomodulatorë. Imunomodulatorët që kanë efekt pozitiv në sistemin imunitar quhen imunostimulues, ndërsa ata që kanë efekt shtypës, imunosupresues.

Beta-glukanët janë substanca që i përkasin grupit të parë, pra me mekanizmin e tyre të veprimit forcojnë imunitetin, duke e bërë kështu trupin tonë gati për të luftuar viruset dhe bakteret edhe para se të bien në kontakt me të. Për nga përbërja janë polisakaride, molekulat e të cilave janë të lidhura me lidhje beta-glikozide. Struktura e molekulave të beta-glukanëve dhe lloji i lidhjes glikozide në to ka një rëndësi të madhe, meqenëse shkakton një efekt krejtësisht të ndryshëm biologjik dhe imunofarmakologjik. Një numër i madh studimesh që studiojnë efektet imunomodulatore të beta-glukanëve kanë konfirmuar deri më tani se forma më aktive është beta-1,3/1,6-glukani nga majaja.

### Cili është efekti i tij në organizëm?

Ai punon për të stimuluar formimin e palcës së eshtrave dhe në këtë mënyrë aktivizon prodhimin e leukociteve dhe trombociteve përgjegjëse për luftimin e infeksioneve. Veç kësaj, aktivizon makrofagët, qelizat e leukociteve, detyra kryesore e të cilave është të mbrojnë nga sulmet e qelizave të huaja në trupin tonë. Kur beta-glukani lidhet me receptorin e makrofagëve, makrofagët aktivizohen dhe bëhen deri në 7 herë më efektivë në njojjen dhe shkatërrimin e agjentëve shkaktarë të infeksionit.

Beta-glukani ka aftësinë të rrisë aktivitetin imunitar me 50-120% në 72-96 orët e para pas administrimit oral. Ai gjithashtu rrit në mënyrë jo të drejtpërdrejtë çlirimin dhe aktivitetin e rritur të enzimave: lizozima, elastaza, kolagjenaza dhe çlirimi i citokinave. E gjithë kjo kontribuon në një reagim më të shpejtë dhe më të fortë të organizmit ndaj patogjenëve, gjë që është dëshmuar nga rritja e rezistencës së organizmit ndaj infeksioneve, por edhe reduktimi i simptomave dhe shërimi më i shpejtë i infeksioneve ekzistuese.

Aktiviteti i beta-glukanit fillon midis 24 dhe 72 orëve pas marrjes, kështu që ka kuptim të merren produkte të beta-glukanit edhe kur simptomat janë tashmë të pranishme, jo vetëm në mënyrë parandaluese. Beta-glukani dhe vetitë e tij imunologjike janë veçanërisht të mira kundër simptomave të ftohjes, gripit dhe infeksioneve të rrugëve të sipërme të frysëmarrjes të shkaktuara nga viruset. Studimet kanë treguar se



glukanët ndihmojnë në lehtësimin e simptomave të këtyre sëmundjeve dhe ndihmojnë trupin të përballet me viruset e madje edhe me bakteret rezistente ndaj antibiotikëve.

Beta-1,3/1,6-glukani konsiderohet si një nga imunomodulatorët më të sigurt, sipas studimeve të disponueshme deri më tani. Në vitin 2008, FDA (administrata amerikane e ushqimit dhe barnave) i dha beta-glukanit nga majaja *Saccharomyces cerevisiae* statusin GRAS (status i ushqimit dhe barnave që do të thotë se janë të sigura për t'u përdorur). Beta-glukani është shumë i sigurt për t'u përdorur, por kur zgjidhni beta-glukanin, është e rëndësishme të kihet parasysh se është një lëndë e parë me cilësi të lartë, sepse disa përbërës që mund të jenë të pranishëm në muret e

qelizave të majave mund të ndërhyjnë në përrthithjen e beta-glukanit. Gjegjësisht, pastrimi nënkupton heqjen e manoproteinave dhe lipideve nga muri i qelizave të majave gjatë procesit të prodhimit dhe është një nga imperativët për të arritur biodisponibilitet të shtuar. Dozat minimale të rekomanduara me efikasitet të caktuar të pritshëm janë 250-500 mg beta-glukan.

Mr.farm. Sonja Pecevska



# ЕДИНСТВЕНО САКАШ ЗДРАВЈЕ?



PharmaS®

ОБЕЗБЕДИ го со добар имунитет!

ВИТАМИН Ц, Д И ЦИНК ПРИДОНЕСУВААТ ЗА  
НОРМАЛНА ФУНКЦИЈА НА ИМУНИОТ СИСТЕМ

# CILI TIP I LËKURËS PLAKET MË SHPEJT?

## Lëkura e yndyrshme apo e thatë?

Jetojmë në një kohë kur bukuria fizike është më se e rëndësishme. Ajo bukuri e jashtme, jo vetëm që ndonjëherë na ndihmon të gjemë më lehtë punë, të jemi më mbresëlënës, e thënë thjesht ta arrijmë qëllimin e dëshiruar, por na jep edhe vëtëbesim dhe vëtëvlerësim. Megjithatë, bukuria fizike nuk është e përhershme. Përkundrazi, lëkura si përfaqësuese e bukurisë fizike, kërkon kujdes, ushqyerje dhe vëmendje të vazhdueshme. Nëse filloni të kujdeseni sëc duhet për lëkurën tuaj me kohë, ajo do të shkëlqejë edhe në dekadën e gjashtë dhe të shtatë të jetës.

*"Kujdesuni për lëkurën tuaj. Ajo është veshja që do ta mban çdo ditë deri sa të keni jetë".*

### Tipi i lëkurës dhe shenjat e plakjes së lëkurës

Plakja e lëkurës zhvillon disa shenja:

- Hollimi i lëkurës
- Rrudha
- Njolla të diellit (njolla kafe pas ekspozimit në diell)
- Toni i pabarabartë i lëkurës
- Lëshimi i lëkurës



Shumë pak studime kanë analizuar se sa shpejt shfaqen këto shenja të plakjes në tipa të ndryshëm të lëkurës, nga të cilat vetëm tre studime e kanë analizuar në mënyrë thelbësore këtë çështje dhe me sa duket, të gjitha tregojnë se plakja e lëkurës së thatë është më e shpejtë se plakja e lëkurës së yndyrshme të prur ndaj puçrrave.

### Studimi # 1: Lëkura e thatë mund të hollohet më shpejt se lëkura e yndyrshme

Në këtë studim, studiuesit analizuan plakjen e lëkurës te 60 gra midis moshës 39 dhe 55 vjeç. Ata i ndanë gratë në dy grupe sipas tipit të lëkurës: grupi 1 për lëkurë të thatë ose normale dhe grupi 2 për lëkurë të yndyrshme. Shkencëtarët më pas bënë matje të ndryshme të lëkurës së grave në të dy grupet dhe i krahasuan ato.

Studiuesit gjetën disa dallime, por kur bëhet fjalë për plakjen, ndryshimi më i rëndësishëm është se gratë në grupin 1 kishin lëkurë më të hollë në krahasim me gratë në grupin 2. Sic u përmend më herët, rrallimi i lëkurës është një nga shenjat e plakjes së lëkurës. Me fjalë të tjera, gratë me lëkurë të thatë ose normale kishin lëkurë më të hollë dhe për shkak të kësaj, ndoshta edhe lëkurë me pamje më të vjetër se gratë me lëkurë të yndyrshme.

Ky është një lajm i mirë për njerëzit e prirur ndaj puçrrave, lëkura e të cilëve priret të jetë e yndyrshme. Këto rezultate sugjerojnë se lëkura e prirur ndaj puçrrave mund të hollohet më ngadalë dhe kështu të duket rinore për një kohë të gjatë, ndryshtë nga lëkura e thatë.

Nga ana tjetër, studiuesit nuk gjetën ndonjë ndryshim në rrudha midis dy grupeve, përkatesish, kur bëhet fjalë për rruhat, të njerëzit me lëkurë të thatë/normale dhe të njerëzit me lëkurë të yndyrshme këto shenja të plakjes zhvillohen me pothuajse të njëjtin ritëm.

### Studimi # 2: Lëkura e thatë mund të zhvillojë rrudra më të thella se lëkura e yndyrshme

Në këtë studim, studiuesit donin të shihnin nëse shumica e gjëndrave dhjamore në lëkurë (gjendra që prodhojnë sebum) ngadalësojnë zhvillimin e rruhave. Nëse po, kjo do të sugjeronte që lëkura e thatë duhet të zhvillojë rrudra më shpejt se lëkura e yndyrshme. Për t'u përgjigjur kësaj pyetjeje, shkencëtarët analizuan mostrat e lëkurës nga burrat dhe gratë që kishin vdekur në mosha të ndryshme, nga njëzet deri në nëntëdhjetë vjeç.

Studiuesit matën numrin e gjëndrave dhjamore në lëkurën e mostrave të marra dhe gjithashtu shikuan thellësinë e rruhave në lëkurë. Ata zbuluan se njerëzit që kanë më shumë gjëndra dhjamore në lëkurën e ballit, kanë vetëm rrudra të cekëta. Me fjalë të tjera, sebumi nga lëkura duket se mbron lëkurën në ballë nga rruhat.



Këto gjetje sugjerojnë se lëkura e thatë, e cila prodhon më pak yndyrë (sebum) në lëkurë, mund të zhvillojë rrudha më të thella më shpejt dhe kështu të plaket më shpejt se lëkura e yndyrshme.

### Studimi # 3: Lëkura pa puçrra mund të plaket më shpejt se lëkura e prirur ndaj puçrrave

Në këtë studim, studiuesit donin të shihnin nëse puçrrat te të rintjtë mund të përspejtojnë ose të ngadalësojnë plakjen e lëkurës më vonë në jetë. Çuditërisht, ata zbuluan se njerëzit që nuk kishin pasur kurrë puçrra mund të shfaqin shenja të plakjes së lëkurës më shpejt se ata që kishin pasur puçrra. Me fjalë të tjera, zhvillimi i puçrrave mund të ngadalësojë plakjen e lëkurës!

Së pari, studiuesit ekzaminuan motra binjake që kishin vuajtur nga puçrrat. Më pas analizuan mostrat e gjakut dhe të lëkurës nga gratë dhe kryen teste gjenetike për të kërkuar shenja të plakjes së lëkurës në nivel qelizor. Ata zbuluan se gratë që nuk kishin puçrra kishin dy tipare gjenetike që e bën lëkurën e tyre të plaket më shpejt në krahasim me gratë që vuanin nga puçrrat.

Ky studim është shumë interesant. Por lë shumë pyetje pa përgjigje. Si e mbrojnë puçrrat lëkurën nga plakja? Apo është thjesht një rastësi që njerëzit që vuajnë nga puçrrat plaken më ngadalë?

Për më tepër, studimi nuk është i përsosur. Kufizimi i parë është se studiuesit mbështeteshin vetëm në përgjigjen e pyetësorit të pjesëmarrësve se a kishin pasur puçrra në rinnë e tyre ose jo. Me fjalë të tjera, shkencëtarët nuk e kishin konfirmuar informacionin duke kontrolluar të dhënat mjekësore të pjesëmarrësve. Kjo lë vend për gabime. Një kufizim i dytë është se studimi analizonte vetëm subjektet femra dhe nuk e dimë nëse rezultatet vlefjanë edhe për meshkujt.

Së bashku, rezultatet e këtyre tre studimeve nënkuqtojnë se lëkura e thatë dhe pa puçrra mund të plaket më shpejt se lëkura e yndyrshme dhe e prirur ndaj puçrrave. Megjithatë, këto gjetje janë paraprake. Na duhen më shumë studime përparrë se të mund të nxjerrim përfundime të forta nëse dhe në çfarë mase plakja lidhet me tipa të ndryshëm të lëkurës.

## ANALIZA KOMPLEKSE E LËKURËS 360 - DIAGNOSTIKIMI

### BASHKËKOHOR KOMPJUTERIK I LËKURËS

Ndonjëherë pjesa më e vështirë e gjetjes së trajtimit të duhur për lëkurën tuaj është përcaktimi i problemit. Ndërsa disa probleme kozmetike janë të lehta për t'u identifikuar, të tjerat mund të janë më të rënda. Prandaj është shumë e dobishme të merret një analizë e plotë komplekse e lëkurës. Analiza komplekse e lëkurës 360 jo vetëm që mund të përcaktojë se cilat defekte estetike mund të janë të pranishme në lëkurën tuaj, por gjithashtu mund të përcaktojë trajtimin më adekuat si dhe rrjedhën e duhur të trajtimit.

### ÇFARË ËSHTË NJË ANALİZË KOMPLEKSE E LËKURËS 360?

Analiza komplekse e lëkurës 360 është një mënyrë joinzative për të përcaktuar të gjitha papërsosmëritë e lëkurës që nuk janë të dukshme me sy të lirë, që do të thotë papërsosmëri që ndodhen në shtresat e thella të lëkurës. Është një pajisje e veçantë diagnostikuese me ndihmën e së cilës, përmes filtrave dhe çipave të veçantë të integruar në kombinim me softuerin e integruar, mund të mbledhë dhe zbulojë pothuajse të gjitha defektet kozmetike dhe estetike, duke përfshirë, por pa u kufizar në, hiperpigmentimin, puçrat, shenjat e puçrrave, rruhat, dëmtimet nga dielli, rosacean, poret e zmadhuara, teksturën e pabarabartë, porfirinat, njollat kafe dhe parregullsi të tjera të lëkurës. Dhe jo vetëm në sipërfaqen e saj, por edhe në thellësi, madje deri në shtresën më të ulët të lëkurës, hipodermën, e cila është e padukshme për syrin e njeriut.

### CILAT JANË PËRFITIMET E ANALİZËS KOMPLEKSE TË LËKURËS 360?

Sot ka aq shumë lloje produkteve dhe trajtimesh për kujdesin e lëkurës, saqë është e vështirë të vendosësh se cili është më i miri dhe më i përshtatshmi për nevojat e lëkurës suaj. Në vend që të hamendësoni, të provoni dhe madje të bëni gabime, është më mirë të jeni në gjendje të përcaktoni paraprakisht zgjidhjen e duhur për ju. Duke krijuar një profil

të detajuar dhe të plotë të tipareve të fytyrës suaj, ju, së bashku me ndihmën e mjekëve tanë specialistë, mund të diskutoni një kurs të plotë trajtimesh të krijuara posaçërisht për të arritur qëllimet tuaja estetike.

I gjithë procesi është i shpejtë dhe i lehtë. Sistemi kompleks i analizës së lëkurës funksionon shpejt, duke ju lejuar të merrni informacionin që kërkon më shpejt se kurrë. Analiza është tërësisht joinzative, gjë që e bën atë më të sigurt se format e tjera të analizës.

### PLANI INDIVIDUAL I TRAJTIMIT

Bazuar në analizën komplekse 360 të lëkurës dhe rezultatet e marra, krijohet një udhëzues më i lehtë dhe më profesional, i cili përfshin një sërë trajtimesh dhe opzioni për korrigjimin dhe heqjen e të gjitha zonave problematike të lëkurës.

Analiza komplekse e lëkurës 360 jo vetëm që ofron opsiione trajtimi dhe kujdesi që do të ishin më të përshtatshme për lëkurën tuaj, por gjithashtu monitoron përparrimin e trajtimit. Në këtë mënyrë, përvçë efektit pamor që është i dukshëm me sy të lirë, do të mund të ndiqni korrigjimet dhe ndryshimet në shtresat e poshtme të lëkurës që nuk shihen me sy të lirë.

Prof. Dr. Ivica Smilkovski

Profesor i trikologjisë klinike dhe akneologjisë  
101 Skin Clinic



Ново



# Посјајна кожа за само 1 недела

## Спречува предвремено стареење на кожата

со Неоглукозамин®

Природно го забрзува површинското  
обновување на клетките  
за 10 пати

\*Продукт гел крем: Клиничка студија, 32 волонтери; in vitro студија.

Neutrogena®

DEVELOPED WITH DERMATOLOGISTS

Bright Boost



# SINDROMA POST- KOVID DHE NDIKIMI I SAJ NË SHËNDETIN MENDOR

Dr. Dragan Petrovski, specialist i neurologjisë

Në një kohë kur përditshmëria jonë është e mbushur me angazhime që kërkojnë shumë përpjekje mendore, në përgjithësi nuk i kushtojmë mjaftueshëm vëmendje trurit tonë. Pandemia e Kovid-19 ka rritur stresin te shumë njerëz. Kjo ka çuar gjithashtu në një rritje të angazhimeve, gjë që ka rritur nevojën shtesë për një koordinim më të madh në kryerjen e tyre. Prandaj, gjithnjë e më shumë i kushtohet vëmendje shëndetit dhe mirëqenies së përgjithshme, veçanërisht te personat që e kanë kaluar infeksionin.

## Mirëpo, a e dini lidhjen midis Kovid-19 dhe trurit?

Virusi "i ri" korona nuk është më i ri. Prej disa kohësh është pjesë e përditshmërisë sonë, ndaj vazhdimit po zbulohet ndikimi i tij në shëndet. Janë kryer studime të shumta mbi natyrën dhe mekanizmin e veprimit të virusit dhe gjithnjë e më shumë po arrihet në përfundimin se koronavirusi nuk prek vetëm sistemin e fryshtës. Rezultatet e disa studimeve tregojnë se ky virus mund të sulmojë edhe sistemin nervor, gjë që rrit rrezikun e infeksioneve të trurit. Rreth 25% e pacientëve me Kovid-19 kanë raportuar manifestime neurologjike. Studimet vërtetojnë se nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, ky virus mund të shkaktojë ulje të qarkullimit të gjakut në tru, duke çuar kështu në ulje të furnizimit me oksigen. Si pasojë e kësaj, rritet rreziku i dëmtimit të funksioneve njohëse dhe madje edhe zhvillimit të demencës. Duhanpirësit dhe pacientët me sistem imunitar të dëmtuar mendohen se kanë më shumë gjasa të infektohen ose të zhvillojnë ndërlilikime të sistemit nervor qendor.

## Sindroma post-kovid dhe "mjegulla e trurit"

Pas kalimit të infeksionit, shumë pacientë zhvillojnë të ashtuquajturën sindromë post-kovid, e cila mund të zgjasë me javë apo edhe muaj pas kalimit të infeksionit. Kjo sindromë shfaqet te pothuaje një e treta e pacientëve, pavarësisht nëse kanë një formë më të lehtë apo më të rëndë të sëmundjes. Më vonë, kjo sindromë ndihet te rreth

85% e pacientëve që e kanë kaluar virusin. Problemet më të zakonshme të raportuara nga pacientët janë lodhja dhe dëmtimi i funksioneve njohëse, të tillë si kujtesa dhe përqendrimi, kurse kjo sindromë post-kovid njihet si "mjegull truri".

## Mbani trurin tuaj të shëndetshëm

Kujdesi i përditshëm për trurin do të ruajë funksionin jetik të mendjes suaj. Një mënyrë jetese e shëndetshme, aktiviteti fizik dhe ushtrimet e trurit mund të ruajnë funksionin e tij. Për më tepër, një dietë e pasur me fruta, perime dhe arra, të cilat janë të pasura me antioksidantë, mund të ndihmojë në përmirësimin e gjendjes.

Në këtë rast, pa dyshim do të ndihmonte shumë një produkt që përbën ekstrakt të ginkgo bilobas. Ekstrakti i ginkgo bilobas ka edhe efekt antioksidues. Mekanizmat e ndryshëm të veprimit të përbërësve aktivë në ekstraktin e ginkgo bilobas kanë një efekt pozitiv në përmirësimin e qarkullimit të gjakut dhe furnizimit me oksigen në tru, si dhe në qelizat e trurit, gjë që është treguar se ofron mbështetje të mirë për shëndetin e trurit. Përdorimi i rregullt mund të përmirësojë qarkullimin e gjakut dhe të përmirësojë aftësitë njohëse, siç janë kujtesa dhe përqendrimi. Studimet klinike vërtetojnë efektivitetin, sigurinë dhe përbalimin e mirë, edhe me përdorim afatgjatë. Këto veti të ekstraktit të ginkgo bilobas e bëjnë atë të përshtatshëm për t'u përdorur te pacientët me simptoma neurologjike që shfaqen si pjesë e sindromës post-kovid.



# Билобил®



## ЗА ДА ОСТАНАМ ВО ДОБРА ФОРМА

Билобил содржи екстракт од гинкго кој го зголемува снабдувањето на мозокот со кислород и ја одржува менталната виталност.

Го подобрува помнењето и интелектуалниот капацитет



Ginkgo bilobae folii extractum siccum  
60 тврди капсули  
герогама употреба

го подобрува помнењето

KRKA

[www.krka.mk](http://www.krka.mk)

 KRKA

Нашата иновативност и знаење  
создаваат ефикасни и сигурни  
производи со највисок квалитет.

Пред употреба внимателно да се прочита упатството!

За индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејствиа на традиционалниот хербален лек  
консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.



# INFEKSIONET E FRYMËMARRJES - ÇFARË DUHET TË DIMË?

Stina e dimrit shoqërohet me shpeshtim të sëmundjeve virale të frysëmarrjes. Arsyja për këtë janë kushtet në të cilat gjendemi, si për shembull më shumë njëzë në të njëjtën hapësirë të mbyllur e cila nuk ajroset rregullisht, përqendrimi i lartë i lagështisë në ajër e rrjedhimisht në ambiente, ndotja atmosferike dhe mbingarkesa mendore dhe fizike që çon në rënien të imunitetit. Në dimër, trupi funksionon më ngadalë për shkak të të ftohit, duke u bërë kështu më i ndjeshëm ndaj infeksioneve të frysëmarrjes dhe ftohive. Në varësi të mbrojtjes individuale imunologjike dhe psikologjike të organizmit, jo çdo individ reagon dhunshëm apo zhvillon infekcion.

Një tipar i zakonshëm i infeksioneve virale është ngjithmëria e lartë dhe transmetimi i lehtë i tyre nga një person te tjetri. Është vlerësuar se fémijët mund të preken nga deri në 12 infeksione virale brenda një viti kalendarik, të cilat mund të pasojnë njëri-tjetrin. Incidencia e tyre zvogëlohet me rritjen.

Në përgjithësi, infeksionet virale më të shpeshta në të gjitha popullatat e rritura janë ato që prekin traktin e frysëmarrjes dhe atë gastrointestinal, me simptomatologji që lind nga organi i prekur, ndërsa tipar i përbashkët i tyre është pafuqia. Në shumicën e rasteve i hasim gjatë ndërrimit të stinëve.

Viruset e frysëmarrjes mund të prekin traktin e sipërm të frysëmarrjes dhe të manifestohen klinikisht si rinit, faringit, tonsilit, laringit, sinusit, si dhe rrugët e poshtme të frysëmarrjes që përfshihen në kuadrin klinik të bronkitit, bronkiolitit dhe pneumonisë. Infeksionet klinikisht më të rëndë ndodhin kryesisht te fémijët më të vegjël, të moshuarit dhe të sëmurët kronikë.

Infeksionet e frysëmarrjes shkaktohen nga një sërë mikroorganizmash. Shkaktarët më të zakonshëm janë viruset (në 90% të rasteve), si Rhinovirusi, Adenovirusi, Influenza, Parainfluenza dhe më rrallë bakteret dhe kërpudhat.

Mënyrat e transmetimit të infeksioneve të frysëmarrjes

- Drejtpërdrejt - përmes transmetimit të sekrecioneve të hundës nga rrugët e sipërm të frysëmarrjes te të sëmurët. Mund të transmetohet përmes kontaktit me një objekt në të cilin ndodhet virusi.
- Jo drejtpërdrejt - përmes grimave të sekrecionit nga trakti i sipërm i frysëmarrjes, të cilat shpërndahen në ajër përmes teshtitjes dhe kollitjes dhe më pas vijnë në kontakt me lëkurën ose mukozën e personit të infektuar rishtas.

## INFEKSIONET E RRUGËVE TË SIPËRME TË FRYMËMARRJES

Nazofaringiti akut

Inflamacioni akut i hundës dhe fytit njihet gjëresisht si ftohje e zakonshme apo rrufë. Klinikisht manifestohet me teshtitje dhe rrjedhje hunde, fillimisht e lëngshme dhe më pas si mukozë. Nganjëherë shfaqet lodhje dhe kokëdhimbje e lehtë me temperaturë 37 deri në 38 gradë. Sëmundja zgjat rreth një javë. Nuk ka

një kurë efektive për të ftohtin e zakonshëm, ndaj është mirë të rrisni imunitetin. Trajtimi është simptomatik, përdoren barna për uljen e temperaturës, kundër dhimbjes së kokës, pika në hundë etj. Kërkohet respektimi i këshillave të mjekut, regjim higjeno-dietik dhe pushim.

## SINUSITI AKUT

Inflamacioni i mukozës së hundës dhe sinusiti manifestohet me dhimbje koke, zakonisht në zonën ku sinusi është prekur nga inflamacioni, dhimbje të fytit, ulje të nuhatjes dhe shijes, vështirësi në frysëmarrje me hundë, si dhe ënjte të fytyrës dhe të zonës rreth syve. Në terapi përdoret tretësirë fiziologjike nazale dhe bama kundër dhimbjes, si dhe rekomandohet pirja e më shumë lëngjeve dhe lënia e duhanit dhe alkoolit. Inhalacioni mund të ndihmojë në lehtësimin e vështirësive. Zakonisht nuk nevojiten antibiotikë për të trajtuar sinusitin akut kur ai shkaktohet nga një infekzion viral ose fungal.

## LARINGITI AKUT

Inflamacioni i mukozës së laringut zakonisht ndodh në dimër dhe në fillim të pranverës, kur vjen deri te ënjta e telave të zërit dhe ngshtimi i hapjes së laringut. Simptomat përfshijnë kollë të thatë dhe të irrituar, ngjirje zëri, dhimbje të lehta dhe më rrallë, gulçim, dobësi, lodhje dhe temperaturë. Ngjirja e zërit mund të zgjasë disa javë. Rekomandohet pushim, më pak sforcim të telave të zërit, inhalacion i ngrohtë dhe nëse mjeku vendos kështu, këshillohen antibiotikë.

## INFEKSIONET E RRUGËVE TË POSHTME TË FRYMËMARRJES

Bronkiti akut


Bronkiti akut është një inflamacion akut i mukozës së trakesë dhe bronkeve. Ndodh kryesisht gjatë ose menjëherë pas infeksioneve të rrugëve të sipërmë të frysëmarrjes, ftohive, dhimbjeve të fytit ose gripit. Bronkiti akut është më i shpeshtë gjatë muajve të dimrit dhe në më shumë se 90 përqind të rasteve shkaktohet nga virusë të ndryshme, si rinoviruset, virusi respirator sincicial, adenoviruset dhe virusi i influencës dhe parainfluencës. Shkaktarët më të zakonshëm në mesin e baktereve janë: Bordatella pertussis, Mycoplasma pneumoniae, Chlamidia pneumoniae.

## PNEUMONIA (INFLAMACIONI I MUSHKËRIVE)

Pneumonia është një infekzion që ndez mushkëritë dhe mund të prekë njérën ose të dy anët. Ato mund të mbushen me lëng ose material purulent, duke shkaktuar kollitje, ethe, të dridhura dhe probleme me frysëmarrjen. Mikroorganizma të ndryshëm, si bakteret, viruset dhe kërpudhat, mund të shkaktojnë pneumoni.

# ЛИНЕКС® Форте

## ПРОБИОТИК ПРИ ЛЕКУВАЊЕ СО АНТИБИОТИЦИ



1

ЗЕМЕТЕ  
**ЛИНЕКС ФОРТЕ**  
САМО ЕДНА  
КАПСУЛА НА ДЕН



Лекувањето со антибиотици особено со оние кои имаат широк спектар, може да предизвика нарушување на рамнотежата на цревната микрофлора и да предизвика дигестивни пореметувања како надуеност, дијараа, констипација.

Пробиотските бактерии во **Линекс Форте** ја намалуваат честотата и сериозноста на малите до умерени дигестивни симптоми (главно дијараа) и ја одржуваат нормалната цревна функција.

Пред употреба внимателно прочитајте го упатството.  
За индикациите, ризикот од употребата и несаканите ефекти на лекот, консултирајте се со Вашиот лекар или фармацевт.



член на компанијата Sandoz

Лек Скопје ДООЕЛ, Перо Наков 33, Скопје, Р.Македонија, тел +389 2 2550 800

Pneumonia mund tē jetē e lehtë, por edhe e rēndē dhe madje kērcēnuese pēr jetēn. Më e rēndē eshtë te foshnjat dhe fēmijet e vegjel, njerëzit mbi 65 vjeç dhe ata me probleme shëndetësore shtesë ose me sistem imunitar tē dobësuar.

## GRIPI

Gripi eshtë sëmundje akute e rrugëve të fymëmarrjes e shkaktuar nga viruset e influencës së tipit A dhe B, e cila zakonisht shfaqet në numër të shtuar ose në formë epidemike gjatë dimrit. Gjatë kësaj periudhe janë tē shpeshta edhe infekzionet me viruse të tjera të fymëmarrjes që kanë simptoma të njëjtë ose të ngashme me gripin.

Në praktikë eshtë e vështirë tē dallosh nëse bëhet fjalë pēr grip apo ftohje vetëm në bazë të simptomatologjisë, nëse nuk bëhet vërtetimi laboratorik, gjegjësisht mikrobiologjik i shkakut të sëmundjes. Prandaj, pa një diagnozë tē besueshme, këto sëmundje quhen "sëmundje të ngashme me gripin" (influenza like illnesses –ILI) ose klasifikohen si infekzione akute të fymëmarrjes (ARI). Gripi eshtë një sëmundje ngjitetë që përhapet drejtëpërdrejt nga personi në person, kryesisht përmes pikave të vogla të hedhura nga një person i infektuar gjatë kollitjes dhe teshtitjes ose jo drejtëpërdrejt, përmes kontaktit me sekrecionet (lengjet) respiratore të një personi tē infektuar që kontaminon duart e tij ose zonat që ka prekur apo objektet që ka përdorur.

Simptomat e sëmundjes shfaqen 1 deri në 4 ditë pasi virusi tē ketë hyrë në trup. Shumica e njerëzve mund ta transmetojnë virusin te një person tjetër 1 ditë para shfaqjes së simptomave dhe 5-7 ditë pas shfaqjes së sëmundjes. Kjo do tē thotë që një person mund ta transmetojë virusin përpara se tē kuptojë se eshtë i infektuar. Sëmundja ka një fillim të papritur me temperaturë të lartë, dhimbje koke, pafuqi të përgjithshme, rraskapitje, dhimbje muskujsh dhe kyçesh, skuqje dhe dhimbje fyti, lotim të syve dhe sekrecione nazale, si dhe kollë e cila zakonisht eshtë e thatë dhe joproduktive.

Jo çdo pacient i ka tē gjitha simptomat e renditura dhe te disa persona tē infektuar sëmundja mund tē kalojë pa simptoma (sipas tē dhënavë tē disa studimeve kjo përqindje ndryshon nga 20-30%) ose me simptoma tē lehta tē ftohjes. Trajtimi i gripit, ashtu si i ftohjeve, eshtë simptomatik, pra trajtohen simptomat, jo vetë sëmundja. Zbatohet një regjim higjieno-dietik (pushim, marrje e më shumë lengjeve, si pije të nxerha, ushqime tē lehta, vitamina dhe minerale), kurse me rekomandimin e mjekut dhe në varësi tē ashpërsisë së sëmundjes mund tē jepen edhe barna tē caktuara antivirale. Terapia me antibiotikë jepet vetëm në rast tē infeksioneve bakteriale dytësore që përkëqësojnë ecurinë dhe përfundimin e sëmundjes, pra pēr trajtimin e komplikimeve nga gripi, vetëm me recetë tē mjekut.

## TRAJTIMI I INFEKSIONEVE TË FRYMËMARRJES. ÇFARË ESHTË E DREJTË?

Pacientët duhet tē janë tē vetëdijshëm se antibiotikët nuk kanë asnjë efekt mbi viruset dhe nuk duhet tē janë rrugëzgjidhje pēr ftohjet dhe gripin (90% e infeksioneve të fymëmarrjes janë me etiologji virale). Antibiotikët janë barna që përdoren pēr tē trajtuar infekzionet bakteriale, sepse mekanizmi i tyre bazohet në veprimin bakterial dhe baktericid, që do tē thotë se ato, ose vrasin bakteret, ose pengojnë rritjen e tyre.

Përdorimi i panevojshëm dhe i shtuar i antibiotikëve zgjelon aftësinë e tyre pēr tē vepruar kur veprimi i tyre eshtë vërtet i nevojshëm (infekzionet bakteriale). E gjithë kjo çon në zhvillimin e rezistencës (qëndrueshmërisë) së baktereve ndaj antibiotikut. Me kalimin e kohës, rezistenca rritet dhe numri i antibiotikëve efektivë zgjelohet.

Gjatë 25 viteve tē fundit nuk ka asnjë tendencë në zbulimin e antibiotikëve tē rinj dhe përdorimi i tyre në infekSIONE TË RENDË, si dhe përdorimi i vaksinave, po zgjasin jetën e njerëzve në mbarë botën. Ndërgjegjësimi pēr efektet e përdorimit të papërshtatshëm dhe tē paarsyeshme të antibiotikëve në nivel global eshtë i lartë, por ende shumë i ulët në vendet ku përdorimi i antibiotikëve nuk eshtë i rregulluar dhe mund tē merret pa recetë. Nëse duam që antibiotikët tē vazhdojnë tē janë efektivë, duhet t'i përdorim ato në mënyrë tē përshtatshme dhe tē arsyeshme.

Në tē gjitha rastet e infeksioneve respiratore tē shkaktuara nga viruset, terapia eshtë simptomatike, që synon lehtësimin e simptomave të organit të prekur. Pēr dhimbjet e fytit mund tē jepen spreje me përbëres analjetik/antiseptik, pastile, pēr kongestionin e hundës jepen dekongjeste, shpëlarje me tretësira tē kripura izotonike/hipertonike, ndërsa pēr dhimbjet dhe temperaturën jepen analjetikë dhe antipiretikë. Sigurisht, marrja e lengjeve, frutave dhe perimeve tē freskëta si dhe terapia me vitamina eshtë gjithashtu e rëndësishme.

## PARANDALIMI:

### Infekzionet e fymëmarrjes parandalohen nga:

- shmangia e qëndrimit tē zgjatur në ambiente tē mbyllura me shumë njerëz,
- ajrosja e shpeshtë e ambienteve,
- larja e shpeshtë e duarve,
- lënia e duhanit,
- marrja e frutave dhe perimeve tē freskëta,
- plotësimi i vitaminave me zink, magnez dhe vitaminë C,  
si dhe me aktivitet fizik.

Vaksina e gripit siguron një nivel tē përshtatshëm mbrojtjeje kundër viruseve dhe gripit, por jo nga llojet e tjera të virusave. Gabimet më tē shpeshta në trajtimin e infeksioneve të fymëmarrjes janë: ulja e temperaturës që nuk i kalon 38.5 sepse ndërhyr në procesin natyral tē shërimit, marrja e antibiotikëve pa rekomandimin e mjekut dhe marrja e vitaminave vetëm pasi tē ndodhë infekzioni.

## Referencat:

*Respiratory Illnesses: 13 Types of Lung Infections (onhealth.com)*

*Infections of the Respiratory System - Medical Microbiology - NCBI Bookshelf (nih.gov)*

*Respiratory Infections - Chapter 11 - 2020 Yellow Book | Travelers' Health | CDC*

Prim.Ass.Dr. Ilir Demiri – infektolog

Klinika Universitare pēr Sëmundje Infektive  
dhe Gjendje Febrile, Shkup



# Поддршка на имунитетот на целото семејство



*L. reuteri* Protectis (DSM 17938)

\* Витаминот Д придонесува за нормална функција на имунолошкиот систем



БиоГаја Протектис капки со Витамин Д

*L. reuteri* Protectis е еден од најиспитуваните пробиотски ланци и е одобрен како ефикасен и безбеден производ за доносени новородени деца, деца и возрасни. Витаминот Д учествува во градење, раст и одржување на коските кај доенчиња, мали деца и возрасни. Има антиинфламаторни, антиоксидативни и невропротективни својства, го поддржуваат имуниот одговор, мускулната функција и активноста на мозочните клетки.

BioGaia Protectis капки со Витамин D се препорачува:

- За подобрување на имуниитетот
- Како дополнителна терапија, кога се користи антибиотик
- Ја подобрува апсорцијата на калциум и овозможува минерализација на коските
- Ја подобрува невромускулната функција

ewopharma

БиоГаја АД - Препарементарско Собрание  
30, Avenue Franklin Delano Roosevelt, 1000 Skopje  
Tel: 023/374889 E-mail: biogaia@ewopharma.mk

Пред употреба внимателно да се прочита упатството. За индикациите, ризикот од употребата и несаканите дејствија на граничниот производ, консултирајте се со Вашот лекар или фармацевт.

BioGaia.

БИОГАЈА © 2019 EWOPHARMA D.O.O. - Скопје, Македонија

# CURAPROX

## БИДЕЈЌИ Е БИТНО ДА ИМАТЕ ЗДРАВИ ЗАБИ



CURAPROX ultra soft

SWISS PREMIUM ORAL CARE



Четките и пастите за заби Curaprox kids достапни се во сите аптеки и дрогери и на [www.zdrava-nasmevka.mk](http://www.zdrava-nasmevka.mk)

Curaprox Macedonia

curaprox\_macedonia



# EKZEMA E PAKËNDSHME



Mr. Dr. Natasha Teovska Mitrevska  
Dermatovenerologe

Dermatit atopik është një gjendje inflamatore e zakonshme dhe kronike e shqëruar me kruajtje të lëkurës, që mund të prekë të gjitha grupmoshat. Një emër tjeter karakteristik për këtë sëmundje është ekzema, por ky term lidhet më shpesh me shfaqjen e të njëjtave simptoma në duar. Te më shumë se 90%, simptomat e para shfaqen në vitin e parë të jetës dhe te 75%, në vitin e tretë të jetës.

Shkaqet e dermatitit atopik nuk janë plotësisht të njoitura, por në thelb lidhen me zhvillimin e vonuar të sistemit imunitar. Shumë fëmijë në historinë familjare kanë ndonjë nga sëmundjet atopike, si astmë dhe rinitit alergjik. Substanca që shkaktojnë reaksione alergjike quhen alergjenë ushqimore, të cilët janë qumështi i lopës, veza, arrat, kikirikët, bajamat, lajthitë, arrat, agrumet, poleni, pluhuri i shtëpisë, myku dhe qimet e kafshëve.

Karakterizohet nga shfaqja e zonave të thata në lëkurën e kokës, ballit, fytyrës dhe anëve të brendshme (përkulëse) të gjymtyrëve të sipërme dhe të poshtme. Te fëmijët dhe të rriturit zakonisht shfaqet në fytyrë, qafë dhe në anën e brendshme të bërrylave, gjunjëve dhe kyçeve të këmbëve. Te foshnjat, ekzema zakonisht shfaqet në ballë, faqe, bërryla, këmbë, kokë dhe qafë. Ekzema ndonjëherë mund të shfaqet si një reagim i shkurtër që ka simptomë për orë ose ditë, por në raste të tjera simptomat zgjasin më shumë dhe shfaqen si dermatit kronik.

Në thelb të dermatitit atopik është lëkura e thatë, e cila rezulton nga një çregullim në metabolizmin e acidit yndyror të pangopur apo acidit linolenik, që çon në dëmtimin e barrierës së lëkurës. Lëkura thahet, duke lejuar kështu hyrjen e baktereve dhe alergjenëve në të dhe bëhet e trashë dhe e plasaritur, pas çka mund të shfaqen fluska, të cilat krijojnë kore të lokalizuara në qafë, gjunjë dhe bërryla.

Kruajtja e vazhdueshme i bën fëmijët nervozë dhe të acaruar. Në terapi ata edukohen që të shmangin kruajtjen dhe gërvishjet, e cila është masa më e rendësishme e kontrollit, si dhe të shmangin mbinxeljen, veshjen e robave të leshta, gjendjet e djersitjes së madhe dhe përdorimin e sapunëve. Për më tepër, dermatologu i këshillon që të përdorin vetëm preparate të përshtatshme dhe pa përbërës agresivë për qetësimin, hidratimin dhe kontrollin e thatësise së atopisë. Përfitimet e dietës janë gjithashtu efektive, veçanërisht te fëmijët e vegjel, të cilët marrin edukim special edhe për mbrojtjen nga infeksionet dhe rikthimin e infeksioneve bakteriale dhe virale.


Trajtimi varet gjithmonë nga mosha e pacientit, shëndeti i përgjithshëm, si dhe lloji dhe ashpërsia e gjendjes. Trajtimi i dermatitit atopik përfshin gjetjen dhe largimin e alergjenit, por edhe të faktorëve nxitës që e kanë provokuar shfaqjen e tij. Në mjekimin lokal, varësish nga stadi aktual i sëmundjes, duhen përdorur zbutës, emulsione kortikosteroide dhe kremra, të cilët, në varësi të komplikimeve dytësore, kombinohen me antibiotikë.

Përdorimi lokal i inhibitorëve të kalcineurinës çon në zvogëlimin e inflamacionit. Këto bama janë një alternativë e sigurt për glukokortikoidet. Nëse kruajtja është e rendë, mund të jepen antihistamina orale. Terapia duhet të mbikëqyret dhe të jetet vetëm nga një dermatolog.

# НЕУРО-ВИТ

Високи дози на Б витамини (B<sub>1</sub>, B<sub>6</sub>, B<sub>12</sub>)

## ПОМОШ ПРИ НЕВРОПАТСКИ БОЛКИ



- Главоболка (тригеминална невралгија)
- Болки во грбот (интеркостална невралгија)
- Болки во крстот (лумбаго)
- Болки во вратот (цервикална болка)
- Болки во нозете (ишијалгија)
- Болки во рака или рамо
- Неуровит помага во исхрана и регенерација на оштетените нерви

1 x 24 h



Невропатска болка се јавува поради повреда или оштетување на нервите, а се манифестира во вид на остру пулсирачка болка или во вид на боцкање, трнење, жарење, печенje, на местото на протегање на зафатениот нерв.

**Преземи коншрола,  
решение ѝ осушои.**

**Utidry®**

**Помаѓа во јравилно џо  
функционирање на:**

- Мочниот меур (кесе)
- Долниот уринарен тракт во насока на одржување на контролата на мокрење



[www.pharmanova.mk](http://www.pharmanova.mk)



**Зимска магија на вкусови!**



Good Nature Зимски чај претставува уникатна комбинација од билки со пријатен мирис и со хармоничен вкус што смирува и релаксира. Специјално создадена чайна мешавина која содржи цветови од бозел и од липа, тимјан, сладок корен и плод од сладок анасон, ќе Ве исполни со теплина и ќе Ви овозможи комплетно укивање во ладните зимски денови.

[www.goodnature.mk](http://www.goodnature.mk)  
[www.facebook.com/GoodNatureMKD](http://www.facebook.com/GoodNatureMKD) | [www.instagram.com/goodnaturemk](http://www.instagram.com/goodnaturemk)



Здравјето друго е

# Atmosfera ideale e Vitit të Ri e shenjave të horoskopit



## DASHI

Kjo shenje e zjarrtë mund tē krijojë fishekjarrët e saj! Si njerëz që konsiderohen mjaft ekstrovertë, deshtë janë tē lindur pér argëtim. Pér Vitin e Ri duan gjithmonë tē tērheqin vëmendjen dhe tē argëtohen gjersa kanë forcë. Duke qenë se kanë një rrëth tē gjerë miqsh, ata duan tē jenë pjesë e turmës që kënaqet atë natë. Nuk u pëlqejnë formalitetet dhe përshtaten shpejt me mjedisin në tē cilin gjenden. Personat e kësaj shenje tē horoskopit, në natën e Vitit të Ri duhet tē vishen me rroba ku mbizotëron e kuqja apo e gjelbra. E kuqja ndihmon në marrjen e vendimeve tē reja, ndërsa e gjelbra lidhet me shpresën dhe përtëritjen.



## DEMI

Demat shijojnë organizimin e burkur me shumë dashuri dhe ushqimin e shijshëm. Si një shenje e ndikuar nga Venusi, romanca është pjesë e idesë së tyre pér dashurinë. Pér natën e ndërrimit tē viteve parapëlqejnë një darkë intime tē kaluar me personin e dashur dhe një atmosferë tē qetë. Mënyra ideale pér t'u argëtuar nënkupton shikime romantike, fjalë tē embla dhe një gosti. Të lindurit në shenjën e demit, pér natën e ndërrimit tē viteve duhet tē bëjnë kombinimin e tyre tē modës në ngjyrë vjollce ose portokalli. Ngjyra portokalli pasqyron energjinë që ka demi, ndërsa vjollca pasionin.



## BINJAKËT

Binjakët kanë nevojë pér njerëz! Ata jetojnë dhe ushqehen me komunikim dhe dialog. Atyre u pëlqen tē shkëmbijnë mendime, tē flasin me njerëz tē ndryshëm dhe tē përhapin miqësi. Mënyra më e mirë pér t'u argëtuar pjesëtarët e kësaj shenje është tē shoqërohen me shumë njerëz ku mund tē shkëmbijnë mendime dhe tē lëshojnë muzikë me zë tē lartë. Në mëngjes, kur ta kenë shteruar tē gjithë energjinë, ata ulen në një kolktuk tē rehatshëm me një pije në duar dhe shikojnë me kënaqësi lindjen e diellit. Nëse ka ende dikush që mund tē ecë në hap me energjinë e tyre, ata gjithashtu mund tē kyçen në një bisedë tē thellë. Ngjyra portokalli dhe e bruztë janë shumë tē rëndësishme pér këtë shenje tē horoskopit. Portokalla lidhet me shoqërimin dhe komunikimin, ndërsa e bruzta simbolizon lirinë financiare.



## GAFORRJA

Gaforret janë më tē lumtura në një tryezë plot me tē afërmit e tyre! Gaforret i kukshtojnë rëndësi tē madhe lidhjes emocionale. Ata duan tē jenë me familjen, miqtë dhe tē dashurit e tyre. Argëtimi ideal pér ta janë tezeti, dajat, kushërinjtë, miqtë dhe patjetër, personi i dashur. Sigurisht, me ta janë edhe dashnorët e tyre... Pér ta kanë rëndësi tē madhe vlerat familjare dhe atmosfera e shtëpisë dhe momentet më tē bukura në jetën e tyre noddohin në një ambient tē tillë. E bardha dhe e argjendta janë ngjyrat që gaforet duhet tē preferojnë natën e ndërrimit tē viteve. Këto dy ngjyra do tē aktivizojnë ndjenjën e tyre tē paqes dhe vetëbesimit dhe do t'u rrisin fuqinë e tē menduarit.



## LUANI

Luani është mishërimi i artit dramatik, ata jetojnë me tē madhe. Luani duhet ta jetojë dashurinë e tij në maksimum sepse pér ta dashuria është edhe më e madhe dhe më e rëndësishme se vetëjeta. Prandaj luanët nuk tērhiqen nga festat e mbushura me njerëz. Ata duan një festë tē veçantë pér veten. Pasioni i tyre pér dashurinë i bën ata ta vënë dashurinë në qendër tē festës së Vitit të Ri. Luanët janë tē paparashikueshëm; në natën e Vitit të Ri mund t'i propozojnë tē dashurës martesë dhe ta mbajnë pér dore apo ta çojnë në një surprizë dhe pushim tē shkurtër. Ngjyra e verdhë apo e artë është ideale pér kombinimin e veshjes në natën e ndërrimit tē viteve. Këto janë ngjyrat që reflektojnë dritën dërheqin vëmendjen.



## VIRGJËRESHA

Virgjëreshat do tē donin tē ishin organizatorët e festës së ndërrimit tē viteve. Ata e shijojnë përgatitjen, duke i bërë listat e tē ftuarve, duke blerë gjërat e nevojshme dhe duke përzgjedhur këngët që do tē dëgjojnë në festë. Nga dëshira pér tē pasur kontroll mbi festën, ata mund tē harrojnë kënaqësinë e tyre. Pér virgjëreshat, gjëja më e rëndësishme është tē kënaqin nevojat e mysafrivëre tē tyre dhe që gjithçka tē shkojë sipas planit. Kur është fjalë pér kombinimin e rrobave me ngjyra tē caktuara, pér natën e ndërrimit tē viteve virgjëreshat duhet tē kombinojnë ngjyrën e kuqe me tē bardhë. E kuqja do tē kontribuojë në aftësinë e tyre tē komunikimit, ndërsa e bardha do tē theksojë mendimin e tyre tē pastër.





## PESHORIA

Pjesëtarët e kësaj shenje të horoskopit dëshirojnë të kenë një darkë të qetë me miqtë e tyre më të mirë. Ata duan që nata e Vtit të Ri të jetë elegante dhe e këndshme. Festat e zhurmshme dhe turmat e mëdha përfundimisht nuk janë pjesë e mënyrës së tyre për të shijuar natën. Peshoret dëshirojnë të kenë privatësi dhe momente ku mund të dallohen. Ata e dinë saktësish se çfarë lloj muzike dëshirojnë të dëgjojnë, çfarë të pinë dhe kë të ftojnë në tryezën e Vtit të Ri. Atmosfera relaksuese dhe ndoshta romantike do të jetë ideale për të pritur Vtit e Ri. E kaltra dhe e kuqja janë padyshim ngjyrat e peshores. E kaltra do t'i ndihmojë të gjejnë rehati në planet e reja të biznesit, ndërsa e kuqja do t'i qartësojë parashikimet e tyre përparrë se të marrin një vendim të caktuar.



## AKREPI

Akrepat plot temperament i shijojnë festat e çmendura me surpriza. Nëse mendojnë se nuk ka kush t'u bëjë një surprizë që do të mbahet mend gjatë, ata marrin masa vetë. Akrepat kënaqen duke qenë pjesë e skenës ku luhet deri në orët e para të mëngjesit, u pëlqen të këndojnë dhe të argëtohen gjersa të mos i mbajnë më këmbët. Sigurisht, disa akrepa mund të jenë krejtësisht të ndryshëm dhe më të tërhequr. Disa pjesëtarë të kësaj shenje mund të parapëlqejnë një darkë romantike për dy persona ku do të shijojnë momentet emocionale me partnerin. Vjollca dhe e verdha janë ngjyrat që duhet t'i kombinojnë akrepat për natën e ndërrimit të viteve. E verdha do t'i ndihmojë të kapërcejnë problemet emocionale, ndërsa vjollca do të theksojë anën artistike të akrepave.



## SHIGJETARI

Pjesëtarët e kësaj shenje të horoskopit do të duan të shkojnë në një restorant elegant dhe luksoz për natën e ndërrimit të viteve. Shumë shigjetarë mezi presin një mundësi të tillë për t'u veshur dhe për të vizituar një vend ekstravagant ku mund të shkëlqejnë. Ata kënaqen me pamje të këndshme dhe specialitete nga ndonjë kuzhinë botërore. Për natën e ndërrimit të viteve u pëlqen luksi, argëtimi dhe një pamje e buruk kah qyteti. Atyre u pëlqen ta kalojnë natën në shoqëri të këndshme ku mund të flasin për tema të pazakonta dhe të ndjehen të veçantë. Për t'mbajtur vëmendjen te vetja, rrobat e tyre duhet të shkëlqejnë në një ngjyrë mbresëlënëse, si rozë, ose të kenë diçka me shkëlqim që do të pasqyrojë energjinë e tyre.



## BRICJAPI

Për bricjapët, gjithçka duhet të jetë e përkryer! Kur bëhet fjalë për festime të mëdha apo një datë të rëndësishme, bricjapët i kushtojnë rëndesi të madhe organizimit. Nëse organizojnë një festë në shtëpi, duan që ajo të mbahet mend gjatë dhe të flitet për të gjatë gjithë vitit. Ata kënaqen duke planifikuar çdo detaj dhe duke paraparë çdo mundësi, sepse nuk duan situata të paparashikueshme. Bricjapët dinë të kënaqen në shoqëri intime, por edhe mes një turme njerëzish. Gjëja më e rëndësishme është që të jetë e gjitha me stil, e sofistikuar dhe me shije. Nëse veshja e tyre e Vtit të Ri ka pjesë kafe ose të kaltra, ata do të ndihen të respektuar dhe të fuqishëm.



## UJORI

Ujori nuk duhet ta fshehë fëmijën e lëvizshëm brenda vetes. Pjesëtarët e kësaj shenje për natën më të çmendur duan një atmosferë në të cilën nuk do të ketë nevojë të përmbahen. Edhe pse disa ujorë dinë të shijojnë një shoqëri më të vogël dhe më intime, shumë prej tyre kanë ide të ndryshme. Meqenëse adrenalina e tyre e madhe i bën të mendojnë për festa të jashtëzakonshme të Vtit të Ri, nuk duhet t'ju vijë si befasë nëse e fillojnë vitin e ri duke bërë zhytje në një vend tropikal ose duke bërë ski në Alpe. Kur bëhet fjalë për ngjyrat që duhet të përdorin për stilin e Vtit të Ri, ato janë ngjyra e kaltër dhe vjollcë, të cilat janë ngjyra që simbolizojnë pafundësinë dhe lirinë.



## PESHQIT

I gjithë fokusi i pjesëtarëve të kësaj shenje është te romanca. Peshqit nuk e konsiderojnë të përshtatshme asnjë festë, nëse nuk ka emocione, momente romantike dhe dashuri. Edhe në qoftë thjesht një darkë intime me partnerin apo me miqtë e ngushtë, peshqit kënaqen në një atmosferë ku mbizotërojnë drita e qirinje, muzika qetësuese dhe bisedat këndshme. Gjatë momenteve të tillë të rëndësishme, atyre u pëlqen të flasin për emocionet, ëndrrat dhe planet e tyre. Peshqit kanë gjithmonë në botën e tyre ide që ndonjëherë janë larg realitetit dhe atyre u pëlqen që t'i ndajnë ato me të dashurit e tyre. Për natën e ndërrimit të viteve, ngjyrat që duhet të mbizotërojnë në veshjen e tyre janë e gjelbra apo e kuqja. Edhe pse nuk janë të parapëlqyerat e tyre, këto janë ngjyrat që do të ndikojnë pozitivisht në jetën e tyre dashurore.



<b>MANASTIR</b>	<b>KUMANOVË</b>	<b>BARNATORJA AMBROZIA FARM</b>	<b>BARNATORJA REGINA</b>	070-623-207
BARNATORJA VIOLA	BARNATORJA ADONIS	02-3224-399	02-2622-205	<b>BARNATORJA MEDIKA</b>
047-222-235	031-411-098	BARNATORJA ANDREA LEK	BARNATORJA SARA FARM	044-339-466
BARNATORJA NEO FARM	BARNATORJA DAFINA	02-3225-422	AERODROM	<b>BARNATORJA FARMAKON</b>
047-224-301	031-413-977	BARNATORJA BETI	075-239-975	071-547-912
BARNATORJA FARM-ZDRAVJE	BARNATORJA ISIDORA	070-322-633	BARNATORJA SARA FARM 1	<b>BARNATORJA SANO FARM</b>
047-223-039	031-550-635	BARNATORJA VIVALEK 1	02-2792-880	<i>f.PIROK</i>
BARNATORJA FARM-ZDRAVJE 2	BARNATORJA KAMILICA	02-2617-740	BARNATORJA SARA FARM 2	044-371-579
047-242-039	031-550-603	BARNATORJA VIVALEK 2	02-2778-709	<b>BARNATORJA HERBA FARM 2</b>
<b>DEMİR HISAR</b>	<b>BARNATORJA NOVALEK</b>	02-2562-222	BARNATORJA SARA FARM 3	<i>f.TEARÇE</i>
BARNATORJA DEHI FARM	031-422-111	BARNATORJA VIVALEK 3	02-3220-049	071-224-827
047-276-644	BARNATORJA FARMALEK	<i>f.CRESHEVË</i>	BARNATORJA SARA FARM 4	<b>BARNATORJA MENA FARM</b>
<b>GJEVGJELI</b>	031-416-503	02-2573-953	02-3113-129	<i>f.VRATNICË</i>
BARNATORJA NIMA	BARNATORJA FILIZ	BARNATORJA GOLD MUN 2	BARNATORJA SARAJ FARM	078-415-079
034-214-562	031-416-700	02-2616-338	02-2057-069	<b>BARNATORJA LOSIONES MEDIKA</b>
<b>GOSTIVAR</b>	<b>BARNATORJA KAISER FARM</b>	BARNATORJA GOLD MUN 3	BARNATORJA STEM	<i>f.PALLÇISHT I POSHTEM</i>
BARNATORJA BOTANIK	078-452-702	02-2635-555	02-3176-335	044-391-025
042-211-413	<b>BARNATORJA ZANI FARM</b>	BARNATORJA GOLD MUN 5	<b>SHTIP</b>	<b>VEVÇAN</b>
BARNATORJA DITI FARM	031-445-434	02-2431-600	BARNATORJA BIOLEK	BARNATORJA BELADONA
042-212-164	<b>NEGOTINË</b>	BARNATORJA GOLD MUN 7	032-391-777	070-362-210
BARNATORJA DITI FARM 3	BARNATORJA NEGOTINË	070-269-866	BARNATORJA DIANA	<b>VELES</b>
042-622-888	043-361-433	BARNATORJA GOLD MUN 9	032-392-707	BARNATORJA ZHIVA FARM 1
BARNATORJA PRO-FARM	BARNATORJA NEGOTINË 1	02-2666-840	BARNATORJA ZDRAVJE 1	043-235-121
042-213-132	043-361-433	BARNATORJA DA-JANA-FARM	078 264 148	BARNATORJA ZHIVA FARM 2
BARNATORJA VIVALEK 4	<b>NOVO SELLË</b>	02-2655-500	BARNATORJA ZDRAVJE 2	043-251-005
042-313-496	BARNATORJA ZDRAVJE	BARNATORJA DATEL FARMA	078 264 141	BARNATORJA ZHIVA FARM 3
BARNATORJA MED-FARM	034-522-279	02-2612-536	BARNATORJA MEDIFARM	043-230-121
<b>F.ÇEGRAN</b>	<b>OHËR</b>	BARNATORJA DNA ANNI FARM	032-394-143	BARNATORJA ZHIVA FARM 4
042-321-363	BARNATORJA BIO-LEK	02-2445-935	BARNATORJA RADOLEK 3	043-225-255
BARNATORJA GENIUS-FARM	BARNATORJA KAVAJ	BARNATORJA EKO FARM, HARAÇİNË	032-380-190	BARNATORJA ZHIVA FARM 5
<b>f.DOBËRDOLL</b>	046-260-580	070-902-960	<b>STRUGË</b>	078-371-585
042-311-229	BARNATORJA PASHOLI	BARNATORJA EKO FARM	BARNATORJA BELADONA	<b>BARNATORJA MAGNA FARM 2</b>
BARNATORJA ALBI FARM	046-255-070	070-902-960	046-786-750	043-211-499
<b>f.GRADEC</b>	BARNATORJA PLANTA	BARNATORJA JASMIN	BARNATORJA HEMAMELIS	<b>VINICË</b>
071-822-270	046-250-533	02-2794-349	046-702-706	BARNATORJA ARKA
BARNATORJA NEO-FARM	BARNATORJA HELEDONA	BARNATORJA LIFELINE	BARNATORJA HAMAMELIS 2	033-362-685
<b>f.NEGOTINO</b>	046-257-744	02-3075-576	<i>f.VRANISHTË</i>	BARNATORJA ARKA NOVA
042-222-201	<b>PRILEP</b>	BARNATORJA LINCURA	046-702-706	033-364-685
<b>KAVADAR</b>	BARNATORJA 2005 VIVA FARM	02-2434-600	<b>STRUMICË</b>	
BARNATORJA FARMAKON-LEK	048-400-901	BARNATORJA LINCURA 2	BARNATORJA VERBENA	
043-411-891	BARNATORJA BIOLEK	02-3114-303	034-551-031	
BARNATORJA FARMANEA	048-416-208	BARNATORJA MAK FARM	BARNATORJA VERBENA 2	
043-550-900	BARNATORJA KARAKASH 1	02-3071-289	034-550-519	
<b>KÉRCOVË</b>	048-414-722	BARNATORJA MAKMEDİKA	BARNATORJA ZHANINA	
BARNATORJA HERBA 1	BARNATORJA MENTA FARM 1	02-2031-082	034-346-972	
045-223-978	048-422-551	BARNATORJA NELA FARM	BARNATORJA ZHANINA 2	
BARNATORJA HERBA 2	BARNATORJA MENTA FARM 5	02-2477-900	079-273-700	
045-261-265	048-550-110	BARNATORJA NIKA FARM	BARNATORJA PANACEA	
BARNATORJA BLINA	BARNATORJA ORTOFARM	02-2572-801	034-320-395	
045-222-550	048-436-100	BARNATORJA NIKA FARM 1	BARNATORJA FARMAKA	
<b>KOÇAN</b>	<b>PROBISHITIP</b>	02-2545-111	034-322-251	
BARNATORJA FITOMED	BARNATORJA EMA FARM	BARNATORJA OMEGA FARM 1	<b>TETOVË</b>	
033-273-805	032-482-666	02-3125-202	BARNATORJA BAMI KOR MEDIKA	
BARNATORJA HIGIA FARM	<b>RADOVISH</b>	BARNATORJA OMEGA FARM 3	044 335 747	
033-271-522	BARNATORJA FILIPI I DYTË	02-3114-086	BARNATORJA E QYTETIT TETOVË	
BARNATORJA IRIS	071-945-549	BARNATORJA OPIUM	044-334-425	
033-272-820	<b>RESNJË</b>	02-2440-335	BARNATORJA ELIXIR	
BARNATORJA IRIS 2	BARNATORJA SIGIA-FARM	BARNATORJA OSKAR LEK	070-887-393	
033-271-645	047-454-360	02-3132-227	BARNATORJA BIOFARM	
<b>KRIVA PALLAKË</b>	BARNATORJA FARMA-LEK-2005	BARNATORJA PAVLOFARM	044-344-292	
BARNATORJA E QYTETIT	047-452-553	02-2467-589	BARNATORJA VITAL FARM	
031-375-012	<b>SHKUP</b>	BARNATORJA POLIN	071-536-614	
<b>KRIVOGASHTAN</b>	BARNATORJA ALOE	02-2432-002	BARNATORJA DUSHICA FARM	
BARNATORJA MENTA FARM 4	02-2039-915	BARNATORJA POLIN 2	044-451-002	
048-471-987		02-2448-040	BARNATORJA LIRA	

**GJENI  
BARNATOREN  
MË TË AFËRT ME  
SHENJËN BETTY**



Заштитен крем за бебиња

**Sudocrem®**

[www.sudocrem.com](http://www.sudocrem.com)

**Сојузник  
на мајките  
повеќе од 80  
години**

практично  
пакување од  
**60g**



Поголемо  
економично  
пакување од  
**125g**

**Смирува • Негува • Штити**

Посебниот хипоалергенски состав ја штити и смирува  
црвената и оштетена кожа, вклучително и пеленската регија  
и другите места со испукана и надразната кожа

**PLIVA**

[www.pliva.com](http://www.pliva.com)

[www.plivazdravlje.hr](http://www.plivazdravlje.hr)

ПЛИВА ДООЕЛ Скопје  
Никола Парапунов б.б. Скопје  
тел./факс +389 2 3062702

MK/SUD/18/0003



# LIVSANE

## LIVSANE Топол напиток со ѓумбир, мед и лимон За поддршка на имуниот систем



...бидејќи Вашето семејство го заслужува најдоброто.